



# PLANI OPERACIONAL

I PROGRAMEVE DHE MASAVE AKTIVE TË PUNËSIMIT  
DHE SHËRBIMET E TREGUT TË PUNËS PËR VITIN 2021

# PËRMBAJTJA

## LISTA E SHKURTESAVE

<b>HYRJE</b>	3
<b>1.PROGRAMET DHE MASAT E PUNËSIMIT</b>	4
1. Mbështetja e vetëpunësimit (sipërmarrësisë)	5
<b>2.MBËSHTETJA E KRIJIMIT TË VENDEVE TË REJA TË PUNËS</b>	5
2.1 Subvencionimi i pagave	9
2.2 Punësimi dhe rritja e subjekteve juridike	9
2.3 Mbështetja e punësimit të personave me aftësi të kufizuara	12
<b>3.TRAJNIMET</b>	13
3.1 Trajnimi në vendin e punës për një punëdhënës të njohur	16
3.2 (a) Trajnim për kualifikime profesionale me kërkesë të punëdhënësve	16
3.2 (b) Trajnimet profesionale me kërkesë të punëdhënësve	19
3.2 (c) Trajnimet onlajn për shkathtësi me kërkesë të punëdhënësve	22
3.3 Trajnimet mbi profesionet e kërkuara	25
3.4 Trajnimet për shoferë në kategorinë C dhe D	27
<b>4. TRAJNIMET PËR ZHVILLIMIN E SHKATHTËSIVE DIGJITALE</b>	29
4.1 Trajnimet për shkathtësi të avancuara TI	31
4.2 Trajnimet për shkathtësi të avancuara të TI (me bashkëfinancim) për trajnerë të palicencuar	31
<b>5.PUNË PRAKTIKE</b>	35
5. Punë praktike	38
<b>2.PROGRAMI I ANGAZHIMIT ME PUNË</b>	38
6. Punime publike	40
<b>7.EKONOMIA E KUJDESIT</b>	40
7.1 Puna e dobishme komunitare	42
7.2 Trajnimi dhe punësimi i personave për ofrim të shërbimeve të kujdesit komunitar për personat me aftësi të kufizuara me sëmundje kronike në komunitet	42
7.3 Mbështetja e sipërmarrësisë dhe formimi i subjekteve juridike dhe shërbimdhënësve komunitarë	44
<b>8.PAGIMI I SHITESËS RINORE</b>	47
Pagimi i shtesës rinore	50
<b>II SHËRBIMET E PUNËSIMIT</b>	51
<b>GARANCIA PËR TË RINJ</b>	54
<b>AKTIVIZIMI I PËRFITUESVE TË AMG</b>	55
<b>REHABILITIMI PROFESIONAL DHE PËRFSHIRJA NË TREGUN E PUNËS E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR</b>	56
<b>PLANI I KOMUNIKIMIT</b>	57
<b>KUADRI FINANCIAR</b>	59

## LISTA E SHKURTESAVE

<b>APRMV</b>	Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë së Veriut
<b>MATP</b>	Masat aktive në tregun e punës
<b>AMSRMV</b>	Agjencia e Mbështetjes së Sipërmarrësisë e Republikës së Maqedonisë së Veriut
<b>NJVL</b>	Njësia e Vetëqeverisjes Lokale
<b>PIP</b>	Plani Individual i Punësimit
<b>MASH</b>	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
<b>MPPS</b>	Ministria e Punës dhe Politikës Sociale
<b>ME</b>	Ministria e Ekonomisë
<b>PO</b>	Plani Operacional
<b>UO</b>	Udhëzimet Operacionale
<b>UNDP</b>	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
<b>UNOPS</b>	Programi i Kombeve të Bashkuara për Mbështetjen e Projekteve
<b>E4E</b>	Projekti Arsimimi për Punësim në Maqedoninë e Veriut
<b>DAP</b>	Drejtoria e të Ardhurave Publike
<b>QP</b>	Qendra e Punësimit
<b>QARR</b>	Qendra për Arsimimin e të Rriturve
<b>RQRMV</b>	Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut
<b>QATP</b>	Qendra e Arsimit dhe Trajnimit Profesional Center for Social Work
<b>QPS</b>	Qendra e Punëve Sociale
<b>BNJVL</b>	Bashkësia e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale
<b>SDC</b>	Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim

## HYRJE

Kuadri i politikave të punësimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut përkufizohet me Programin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, Programin e rishikuar të Reformave në Punësim dhe në Politikën Sociale 2022 dhe është në pajtim me detyrimet që burojnë nga Traktati Global për Vendet e Punës të Organizatës Botërore të Punës (OBP), Plani i Garancisë për të Rinj 2020-2022, Programi i Financimit Buxhetor IPA, reformat në sistemin e mbrojtjes sociale dhe aplikimi i asistencës minimale të garantuar.

Me Planin Operacional të Programeve dhe Masave Aktive të Punësimit dhe Shërbimeve të Tregut për vitin 2021, përcaktohen programet, masat dhe shërbimet e punësimit, të cilat do të sigurojnë krijimin e vendeve të reja të punës, mbështetjen në krijimin e vendeve të reja të punës dhe rritjen e kapacitetit të punësimit të personave të papunë, sidomos të të rinjve, personave që janë të papunë për një kohë të gjatë dhe ushtruesve të së drejtës së asistencës financiare nga mbrojtja sociale (në tekstin e mëtejshëm: asistencë minimale e garantuar), si dhe mbështetja e të papunëve, përfundimi i marrëdhënies së punës, të cilët janë regjistruar në periudhën e krizës së shkaktuar nga Koronavirusi COVID 19 (nga data 11.03.2020).

Në zbatimin e programeve dhe masave të punësimit, si dhe të shërbimeve të tregut të punës, do të respektohen parimet bazë si më poshtë:

- ◆ Përballja e efekteve dhe pasojave negative mbi tregun e punës dhe kapacitetin e punësimit, të shkaktuara nga pandemia COVID-19;
- ◆ Parimi i diversitetit dhe përfshirjes për të gjitha kategoritë shoqërore në sektorin privat, konform parimeve të përfaqësimit të drejtë dhe adekuat të kategorive vulnere etnike, gjinore, fetare, racore ose të cilësdo kategorie tjetër vulnere të qytetarëve, në përputhje me standardet dhe praktikatat e Kombeve të Bashkuara dhe të Organizatës Ndërkombëtare të Punës;
- ◆ Inkurajimi i zhvillimit të barabartë rajonal, në përputhje me të dhënat e Byrosë së Zhvillimit Rajonal dhe me shkallën e zhvillimit të rajoneve planore në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Të gjithë të papunët dhe punëdhënësit e evidentuar kanë akses në programet apo në masat dhe shërbimet e punësimit<sup>1</sup>. E drejta e pjesëmarrjes përcaktohet duke u bazuar te kushtet dhe kriteret e përkufizuara për çdo program apo masë dhe shërbim punësimi veçanërisht, ndërsa si rregull i veçantë, do të insistohet në arritjen e përfaqësimit të barabartë të burrave dhe grave, konform Ligjit të Mundësive të Barabarta të Grave dhe Burrave, si dhe në pjesëmarrjen e personave të rinj deri në moshën 29 vjeç me të paktën 30%.

Në të njëjtën kohë, në shpërndarjen e mjeteve financiare dhe përzgjedhjen e pjesëmarrësve në programet dhe masat e punësimit në kuadrin e këtij Plani Operacional, do të merret parasysh dhe Zhvillimi i Barabartë Rajonal. Më konkretisht, do të merren parasysh kriteret e Vendimit mbi klasifikimin e rajoneve planore sipas shkallës së zhvillimit për periudhën 2018-2023 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 234 /18), të cilat do të merren në konsideratë gjatë shpalljes së thirrjeve publike në ato programe dhe masa të Planit Operacional, ku kjo gjë është e aplikueshme. Në thirrjet publike do të përcaktohen kuotat e numrit të ndërmarrjeve që do të subvencionohen sipas rajoneve planore, sipas parimit “ai që vjen i pari, i shërbehet i pari”.

Procedura e zbatimit të programeve, masave dhe shërbimeve të punësimit përkufizohet me Udhëzimet Operacionale të sjella nga APRMV, në bashkëpunim me partnerët e tjerë në implementim.

Përfshirja e personave të papunë në programet apo masat e punësimit kryhet në bazë të proceseve transparente të aplikimit, e deri në përmbushjen e shtrirjes së planifikuar, apo deri në fund të nëntorit 2021. Shërbimet që ofron APRMV vazhdojnë gjatë tërë vitit.

Personat e papunë dhe punëdhënësit informohen mbi mundësinë e pjesëmarrjes në programet, masat dhe shërbimet në shumë mënyra (me telefon, SMS, e-postë, thirrje publike). Me pjesëmarrësit lidhet një kontratë përkatëse, e cila më hollësisht rregullon të drejtat dhe detyrimet e tyre.

1 Gjatë pjesëmarrjes së personave të papunë në programet dhe masat e përgatitjes për punësim dhe angazhim pune (programet: 3, 4, 5, 6, dhe gjatë trajnimeve për masat, 7.2 dhe 7.3), ata do t'i ushtrojnë edhe të drejtat e përfituara në bazë të Ligjit të Mbrojtjes Sociale dhe të drejtat me bazë papunësinë.

Me Planin Operacional për Vitin 2021, theks i veçantë vihet te të papunët e rinj deri në moshën 29 vjeç, personat që janë të papunë për një kohë të gjatë, si dhe te përfituesit e asistencës minimale të garantuar.

Në zbatimin e Planit Operacional, shtrirja e personave të përfshirë me programet / masat e punësimit mund të përshtatet, si dhe mjetet financiare mund të ricaktohen brenda mjeteve financiare të parashikuara, bazuar në vëzhgimet dhe analizat e APRMV dhe institucioneve dhe organeve të tjera kompetente, me propozimin e APRMV, për të cilin Ministri i Punës dhe Politikës Sociale jep pëlqimin e vet.

Bartësi i Planit Operacional është Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, dhe zbatimi i tij është nën juridiksionin e Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në partneritet me institucionet e tjera përgjegjëse. Në zbatimin e Planit Operacional, secili institucion kompetent do të sigurojë të dhëna mbi shkallën e zbatimit.

# I.PROGRAMET DHE MASAT E PUNËSIMIT

## 1.1.MBËSHTETJA E VETËPUNËSIMIT (SIPËRMARRËSIS)

Programi i Vetëpunësimit dhe Mbështetjes është destinuar për personat e papunë, në nisjen e biznesit vetjak.

<b>Titulli i masës</b>	<b>1. Mbështetja e vetëpunësimit (sipërmarrësisë)</b>
<b>Qëllimi i masës</b>	Mbështetja e personave të papunë në nisjen e biznesit vetjak
<b>Grupi qëllimor</b>	Personat e papunë të regjistruar në APRMV
<b>Shtrirja e masës</b>	1762 persona të punësuar në subjekte të sapokrijuara
<b>Institucioni kompetent</b>	MPPS, APRMV, ME-AMSRMV, RQRMV, UNDP, Shoqata REDI Shkup

### Shuma e mbështetjes financiare

Deri **307.500** denarë apo deri **615.000** denarë (në qoftë se themelohet një subjekt juridik me dy bashkëthemelues).

### Përfituesit

- ◆ Të rinjtë e papunë deri në moshën 29 vjeç
- ◆ Të papunët me aftësi të kufizuar
- ◆ Të papunët
- ◆ Gratë e papuna që vijnë nga kategoritë vulnerabil dhe të marginalizuara
- ◆ Të papunët që synojnë formalizimin e biznesit të vet
- ◆ Romët e papunë
- ◆ Personat e papunë për shkak të Koronavirusit

**Vërejtje** Përfitues të Programit mund të jenë dhe personat e papunë që kanë kryer trajnimin e sipërmarrësisë dhe/ose kanë hartuar një Plan Biznesi në vitin 2020.

### Mënyra e aplikimit

Thirrje Publike / Njoftim, kërkim në regjistrat e të papunëve, Fletëparaqitje dhe Pyetësor për vlerësimin e afiniteteve sipërmarrëse

### Kriteret

Pjesëmarrja në Program dhe përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet me bazë konkurrueshmërinë, në përputhje me kriteret e mëposhtme:

- ◆ Pyetësori i plotësuar me sukses;
- ◆ Plani i hartuar dhe i zgjeruar i Biznesit (me vështrim të posaçëm në analizën e konkurrueshmërisë dhe analizën SWOT, analizën e kandidatit) me mbështetje këshillëdhënëse;
- ◆ Plani i Biznesit i vlerësuar pozitivisht nga komisioni ekspert;
- ◆ Personat me aftësi të kufizuar që do të përzgjidhen për regjistrimin e një subjekti juridik, do të marrin mundësinë e ndjekjes së një trajnimi onlajn mbi “Sipërmarrësinë dhe Zhvillimin e Shkathtësive Sipërmarrëse”;

Kompanitë e themeluara nga persona me aftësi të kufizuar, në qoftë se posedojnë një Plan Biznesi të qëndrueshëm dhe të përzgjedhur, i cili Plan përmban një punësim plotësues, do të mbështeten me një punësim plotësues.

Programi do të realizohet, duke mbajtur llogari për përfaqësimin rajonal, të përkufizuar me Udhëzimet Operacionale.

Mbështetje mentoriale e personave me aftësi të kufizuar për të paktën 120 orë në zhvillimin e Planeve të Biznesit të vlerësuara pozitivisht.



## KOMBINIMI ME MASA TË TJERA

Përfituesit që do të mbështeten me Programin e Vetëpunësimit dhe që do të arrijnë të regjistrojnë një subjekt juridik dhe do të vetëpunësohen, do të mund t'i bashkëngjiten masës 2.1, Subvencionimi i Pagave dhe 2.2, Punësimi dhe Rritja e Subjekteve Juridike. Mbështetja me një punësim plotësues do të sigurohet deri në përmbushjen e shtrirjes së planifikuar me masat 2.1 dhe 2.2 të Programit të Mbështetjes së Krijimit të Vendeve të Reja të Punës.

## BASHKIMI I PËRFITUESVE

Në rast se dy persona janë të interesuar të fillojnë një ndërmarrje së bashku (si bashkëthemelues), të dy personat e papunë duhet bashkërisht të kalojnë të gjitha hapat e zbatimit (deklarata e pjesëmarrjes, pyetësori, hartimi i një ideje të përbashkët biznesi dhe plani i përbashkët i biznesit, etj.).

Subjekti juridik i themeluar nga dy bashkëthemelues, në Regjistrin e Shoqërive Tregtare regjistrohet si **SHPK - Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me dy persona**, ku secili bashkëthemelues ka aksione të barabarta (50%) në shoqërinë.

## Detyrimet

Në qoftë se personi juridik përfundon veprimtarinë e tij brenda 2 viteve nga regjistrimi i subjektit juridik ose marrëdhënia e punës e përfituesit të grantit pushon për ndonjë arsye (përveç në rast të pazotësisë për të vepruar ose vdekjes) brenda 2 viteve nga krijimi i marrëdhënies së punës, themeluesi/përfituesi i grantit detyrohet të kthejë:

- 80% të grantit, në qoftë se ndërprerja ndodh në vitin e parë të regjistrimit të subjektit juridik; apo
- 60% të grantit, në qoftë se ndërprerja ndodh në vitin e dytë të regjistrimit të subjektit juridik. Themeluesi/përfituesi i grantit që do t'i japë fund ushtrimit të veprimtarisë, nuk mund të kthehet në regjistrat e të papunëve për 3 vjet nga dita e lidhjes së marrëdhënies së punës.

Subjekti juridik i cili merr në punë një person tjetër në kuadrin e këtij Programi, detyrohet ta punësojë këtë person me orar të plotë pune dhe ta mbajë në punë për të paktën 12 muaj, në qoftë se bëhet fjalë për një person deri 29 vjeç, apo 9 muaj në qoftë se bëhet fjalë për një person mbi 29 vjeç.

Në qoftë se gjatë periudhës së detyrimit të parashikuar, pushon marrëdhënia e punës së punëmarrësve shtesë, përveç nëse arsyet e pushimit të marrëdhënies së punës janë vdekja ose pazotësia për të vepruar, punëdhënësi detyrohet të punësojë një person tjetër të papunë të regjistruar në APRMV, ose të kthejë mjetet financiare në një shumë proporcionale me detyrimin e përcaktuar për numrin e zvogëluar të punëmarrësve.

Subjekti juridik / përfituesi që mbështetet në përputhje me këtë Program detyrohet të përmbushë detyrimet ligjore për pagimin e pagës dhe kontributeve për të gjithë 24 muajt nga dita e lidhjes së marrëdhënies së punës, sepse ndryshe detyrohet të kthejë mjetet e paguara financiare / të shfrytëzuara në plotësi.

Në qoftë se përfituesit dhe njëkohësisht themeluesit i përfundon marrëdhënia e punës para skadimit të 2 viteve nga data e punësimit për arsye të një punësimi tjetër, në vendin e tij duhet menjëherë të punësohet një person tjetër i nga regjistrat e të papunëve në APRMV, punësimi i të cilit duhet qenë në kohëzgjatje të paktën deri në fund të vlefshmërisë së kontratës. Në të kundërtën, ai detyrohet t'i kthejë mjetet e paguara financiare. Për realizimin e këtyre që u përmendën më herët, subjekti juridik - përfituesi duhet të paraqesë një Kërkesë, për të cilën vendos Komisioni i Përzgjedhjes së Pjesëmarrësve në Masat Aktive të Punësimit.

Të drejtat dhe detyrimet janë përshkruar dhe rregullohen me Udhëzimet Operacionale dhe Kontratën.

## Realizimi

- ◆ Thirrja Publike / Njoftimi për Personat e Papunë  
Aplikimi dhe plotësimi i Pyetësorit
- ◆ Hartimi i një Plani të Biznesit me mbështetje këshillëdhënëse të APRMV, me zgjerim të Planit të Biznesit në pjesë të caktuara të cilat bëjnë pjesë të trajnimit mbi sipërmarrësinë
- ◆ Përzgjedhja e planeve të biznesit më të suksesshme, duke marrë parasysh kriteret e përfaqësimit rajonal
- ◆ Trajnimi onlajn mbi “Sipërmarrësinë dhe Zhvillimin e Shkathtësive të Biznesit” për personat me aftësi të kufizuar, të cilët do të shprehin dëshirë

dhe

→ Digjitalizimi dhe formalizimi përmbajnë gjashtë module<sup>1</sup>:

- ◆ Regjistrimi dhe forma e punësimit
- ◆ Punësimi plotësues për biznese të themeluara nga persona me aftësi të kufizuar
- ◆ Shuma e grantit arrin maksimumin e 307.500 denarëve, apo deri 615.000 denarë në qoftë se themelohet një subjekt juridik nga dy bashkëthemelues. Përfituesit do ta marrin grantin në formën e mjeteve financiare për të filluar biznesin e vet
- ◆ Mbështetja këshillëdhënëse/mentorale për 12 muaj nga themelimi i biznesit do të sigurohet për grupet qëllimore si më poshtë:
  - ◆ persona me aftësi të kufizuar;
  - ◆ pjesëtarë të komunitetit rom;
  - ◆ gra nga kategoritë vulnerabil (pranues të asistencës sociale, viktimat të dhunës në familje, viktimat të trafikimit me njerëz, nëna të vetme dhe gra socialisht të përjashtuara me bazë teprica teknologjike dhe falimentimi).

---

1. Programi i Digjitalizimit dhe Formalizimit do të zbatohet nga Nisma për Zhvillimin e Sipërmarrësisë tek Romët – REDI, në bashkëpunim me Agjencinë e Punësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Nisma për Zhvillimin Ekonomik tek Romët - REDI, do të zbatojë një program elektronik përshpejtimi, qëllimi i të cilit është transmetimi i njohurive dhe shkathtësive të 50 bizneseve të drejtuara nga romë, për transformimin e tyre nga biznesi tradicional në një biznes digjital. Qëllimet e trajnimit janë:

1. Ta bëjë të mundur që 50 biznese të drejtuara nga romë nga Maqedonia e Veriut të përdorin punë të mençur (SMART working) në bizneset e tyre përmes qasjes në mjete onlajn dhe në trajnim për biznes digjital;
2. T'i fuqizojë shkathtësitë e planifikimit afarist, planifikimit financiar dhe drejtimit të biznesit për 50 romë nga Maqedonia e Veriut;
3. Transformimi digjital i 50 bizneseve (formale apo joformale), të drejtuara nga romë;
4. Hartimi i 50 planeve të biznesit;



**Vërejtje: Personat që kanë fituar grant në periudhën e kaluar nuk kanë të drejtë për pjesëmarrje në program.**

Me Programin nuk do të mbështetet themelimi i bizneseve në veprimtaritë e mëposhtme:

1. Veprimtaria bujqësore, apo veprimtaria nga Sektori A/A, Seksioni 01 - Prodhimtaria Bimore dhe Shtazore, Gjuetia dhe Veprimtaritë e Shërbimit lidhur me ato, me përjashtim të Prodhimtarisë Bujqësore Organike;
2. Bizneset në veprimtarinë e klasës 49.32 - Shërbimet taksi;
3. Prodhimtaria dhe distribuimi i armëve, apo veprimtaria e klasës 25.40 - Prodhimtaria e armëve dhe municionit;
4. Bizneset dhe aktivitetet financiare dhe të sigurimeve, që përfshijnë lojëra fati, apo veprimtaria e Sektorit K/I - Veprimtaritë financiare dhe veprimtaritë e sigurimeve.

Me përjashtim të pikëve 1 dhe 2, të papunët me aftësi të kufizuar, përfituesit e asistencës minimale të garantuar, personat që kanë humbur vendin e punës për shkak të COVID-19 (që nga muaji mars 2020), romët e papunë, do të mund të regjistrojnë subjekt juridik në veprimtarinë bujqësore dhe në shërbimin taksi.



## 2.MBËSHTETJA E KRIJIMIT TË VENDEVE TË REJA TË PUNËS

Mbështetja e krijimit të vendeve të punës do të inkurajojë punësimin e të papunëve në ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, ndërmarrjet sociale që përqendrohen kryesisht në qëllimet sociale/ shoqërore dhe fitimet e të cilave po riinvestohen për të arritur ato qëllime përmes operacioneve afariste ose investimeve në komunitetet dhe organizatat civile (jofitimprurëse) që merren me aktivitet ekonomik në kryerjen e një veprimtarie, pra një aktivitet që klasifikohet me Klasifikimin Kombëtar të Veprimtarive, me të cilin organizatat arrijnë qëllimet e tyre të përcaktuara me Statut.

<b>Titulli i masës</b>	<b>2.1 Subvencionimi i pagave</b>
<b>Objektivi i masës</b>	Mbështetja e punësimit të personave të papunë që e kanë më të vështirë të inkuadrohen në tregun e punës
<b>Grupi qëllimor</b>	<p><b>Të papunët</b> e regjistruar në APRMV që e kanë më të vështirë të inkuadrohen në tregun e punës:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>◆ personat që janë të papunë për një kohë të gjatë (mbi 12 muaj të regjistruar, ku përparësi kanë personat që janë të papunë për më tepër se 5 vjet)</li> <li>◆ të rinjtë deri 29 vjeç dhe personat mbi 50 vjeç</li> <li>◆ personat e papunë të cilëve u ka përfunduar marrëdhënia e punës në periudhën e Koronavirusit COVID-19</li> <li>◆ të kthyerit nga vendet e jashtme për shkak të krizës së shkaktuar nga Koronavirusi COVID-19</li> <li>◆ përfituesit e asistencës minimale të garantuar</li> <li>◆ përfituesit e asistencës financiare me bazë papunësia</li> <li>◆ personat që kanë pasur statusin e fëmijëve pa prindër dhe pa kujdes prindëror</li> <li>◆ viktimat e dhunës në familje</li> <li>◆ personat me aftësi të kufizuar</li> <li>◆ gratë pjesëtare të komunitetit etnik rom dhe të komuniteteve të tjera etnike</li> <li>◆ pjesëtarët e komunitetit etnik rom</li> <li>◆ personat të cilëve u është zgjidhur statusi me dokumentacionin personal</li> <li>◆ prindërit e vetëm</li> <li>◆ prindërit e fëmijëve me nevoja të veçanta <sup>1</sup></li> <li>◆ prindërit e 3 apo më tepër fëmijëve</li> <li>◆ prindërit e fëmijëve në rrugë</li> <li>◆ personat e dënuar pas lëshimit nga institucioni ndëshkimor-korrektues</li> <li>◆ personat e pastrehë</li> <li>◆ personat me shkollën e mesme të pakryer ose me arsim më të ulët</li> </ul>
<b>Shtrirja e masës</b>	<b>866<sup>2</sup></b> gjithsej personat e papunë të regjistruar në APRMV -(nga të cilët <b>80</b> të papunë - përfitues të asistencës minimale të garantuar, që janë regjistruar në APRMV - me financimin e IPA II - granti i katërt i drejtpërdrejt <sup>3</sup> ).
<b>Institucionet kompetente</b>	MPPS, APRMV, QPS, RQRMV, DAP
<b>Kohëzgjatja e subvencionimit</b>	3, 6 ose 12 muaj

1.Personat e këtij grupi qëllimor do të lidhin marrëdhënie pune për më së shumti 20 orë në javë, konform Ligjit të Mbrojtjes Sociale

2.Në kuadrin e kësaj mase, do të insistohet të përfshihen 120 romë

3.Për 80 persona, 50% nga shuma e përgjithshme e subvencionit, do të sigurohen mjete financiare nga IPA II - granti i katërt i drejtpërdrejtë

## Shuma e mbështetjes financiare

**19.000 denarë** për muaj, si subvencionim i pagës së personit të punësuar **për periudhë nga 3, 6 ose 12 muaj** për punësimin e personave nga rendi i grupeve qëllimore.

Punëdhënësi mund t'i paguajë punëmarrësit një pagë edhe më të lartë.

Mbështetja e plotë financiare për një person për **3 muaj arrin 57.000 denarë**; për **6 muaj arrin 11.4000 denarë** dhe për **12 muaj arrin 228.000 denarë**.

Mjetet financiare paguhen njëherë për tërë periudhën e subvencionimit, pas realizimit të punësimit me orar të plotë, konform dispozitave dhe kushteve të përcaktuara me kontratën e subvencionimit.

## Përfituesit

Kompanitë mikro, të vogla dhe të mesme, ndërmarrjet sociale dhe organizatat e shoqërisë civile (jofitimprurëse) që merren me një aktivitet ekonomik në kryerjen e veprimtarisë së tyre.

Ndërmarrjet e reja të themeluara me ndihmën e Programit të Vetëpunësimit në vitin 2020.

Personat e papunë.

## Mënyra e aplikimit

### Për punëdhënësit:

Thirrje Publike/Njoftim, Fletëparaqitje për Pjesëmarrje dhe Kërkesë Ndërmjetësimi në Punësim.

### Për personat e papunë:

Njoftim, kërkim në regjistrat e të papunëve.

## Kriteret

### Për punëdhënësit:

- ◆ Numri i përgjithshëm i punëmarrësve me afat të pacaktuar në ditën e aplikimit dhe para realizimit të mbështetjes nuk duhet qenë më i ulët se numri mesatar i punëmarrësve<sup>1</sup> me afat të pacaktuar në vitin paraardhës kalendarik, përveç nëse arsyet e uljes së numrit të punëmarrësve me afat të pacaktuar janë përfundimi i marrëdhënies së punës për shkak të dorëheqjes së punëmarrësit, ushtrimit të së drejtës së pensionit, vdekjes, apo pazotësisë për të vepruar;
- ◆ Ka shlyer të gjitha detyrimet me bazë pagat dhe kontributet e paguara për sigurim të detyrueshëm social;
- ◆ Të mos ketë humbje financiare në vitin paraardhës, përveç nëse humbja është bërë për shkak të investimeve kapitale nga subjekti juridik<sup>2</sup>
- ◆ Punëdhënësi duhet të ketë të paktën një person të punësuar me afat të pacaktuar, me përjashtim të organizatave të shoqërisë civile, të cilat në kohën e aplikimit nuk kanë një punëmarrës.
- ◆ Personat të cilëve marrëdhënia e punës (me afat të caktuar apo të pacaktuar):
- ◆ U është përfunduar një vit para punësimit me masën aktive, ata nuk do të mbështeten me punësime të reja tek i njëjti punëdhënësi, me përjashtim të organizatave të shoqërisë civile. Numri i të sapopunësuarve, të cilin punëdhënësi mund ta përfitojë me anë të Programit të Mbështetjes së Punësimit, nuk mund të kalojë 50% të numrit mesatar të punëmarrësve në vitin paraardhës kalendarik, ku numri maksimal nuk mund të jetë më i lartë se 5 persona tek një punëdhënësi, përveç gjatë punësimit të përfituesve të asistencës minimale të garantuar, ku numri maksimal i punëmarrësve, nën këtë masë, do të jetë i pakufizuar. Punëdhënësi që ka një punëmarrës, organizatat e shoqërisë civile që nuk kanë asnjë punëmarrës dhe tek subjektet juridike të regjistruara pas datës 01.07.2020, numri maksimal i punësimeve të mbështetura arrin një person.

1. Termi "numri mesatar i punëmarrësve" ka të bëjë vetëm me nevojat e zbatimit të programeve/masave aktive të punësimit.

2. Ky kriter nuk vlen për subjektet juridike që janë regjistruar pas datës 01.07.2020.

## Detyrimet

**Për punëdhënësit:** Punëdhënësi që punëson një person të papunë detyrohet ta mbajë personin në marrëdhënie të përgjithshme pune për një periudhë nga:

- ◆ **9 muaj**, për 3 muaj subvencionim;
- ◆ **18 muaj**, për 6 muaj subvencionim;
- ◆ **18 muaj**, për 12 muaj subvencionim (për përfituesit e asistencës minimale të garantuar, për të papunët të cilëve u ka përfunduar marrëdhënia e punës pas datës 11.3.2020 për shkak të Koronavirusit COVID- 19 dhe romët) dhe
- ◆ **30 muaj**, për 12 muaj subvencionim.

→ Në qoftë se punëmarrësit të cilit i është paguar subvencionimi i përfundon marrëdhënia e punës në cilëndo periudhë (periudha e subvencionimit dhe periudha shtesë për të cilën detyrohet ta mbajë punëmarrësin në marrëdhënie pune), përveç në rast të vdekjes, pensionit dhe pazotësisë për të vepruar, punëdhënësi detyrohet që brenda 15 ditëve, në vendin e tij të punësojë një person tjetër të papunë - kërkuar aktiv të punës, që i përket cilëndo kategorie në kuadrin e grupeve qëllimore të përfshira me këtë masë, përveç për përfituesit e asistencës minimale të garantuar, ku zëvendësimi patjetër duhet qenë nga i njëjti grup qëllimor. Në të kundërtën, detyrohet të kthejë një shumë proporcionale të mjeteve financiare të paguara (shuma e subvencionit për person, pjesëtuar me numrin e përgjithshëm të muajve).

→ Punëdhënësi detyrohet që për tërë periudhën (periudha e subvencionimit dhe periudha shtesë për të cilën detyrohet ta mbajë punëmarrësin në marrëdhënie pune) të mos ulë numrin e përgjithshëm të punëmarrësve me afat të pacaktuar (të cilët ka pasur në ditën e aplikimit, përfshirë dhe numrin e punëmarrësve me këtë masë), përveç në rastin e përfundimit të marrëdhënies së punës për shkak të vdekjes, pensionimit apo pazotësisë për të vepruar, sepse në të kundërt detyrohet që brenda një afati 15 ditor të punësojë një person tjetër - për të plotësuar numrin, sepse në të kundërt, detyrohet të kthejë shumën proporcionale të mjeteve të paguara financiare (shuma e subvencionit për person, pjesëtuar me numrin e përgjithshëm të muajve).

Të drejtat dhe detyrimet janë përshkruar dhe rregullohen me Udhëzimet Operacionale dhe Kontratën.

## Realizimi

Thirrje Publike/Njoftim, Fletëparaqitje për Pjesëmarrje, ndërmjetësimi dhe kërkim në regjistrat e nga punonjësi i Qendrës së Punësimit, Njoftim nga qendrat e punës sociale.



<b>Titulli i masës</b>	<b>2.2 Punësimi dhe rritja e subjekteve juridike</b>
<b>Qëllimi i masës</b>	Mbështetja e krijimit të vendeve të reja të punës në ndërmarrje mikro, të vogla dhe të mesme, ndërmarrjet sociale dhe organizatat e shoqërisë civile
<b>Grupi qëllimor</b>	Personat e papunë të regjistruar në APRMV
<b>Shtrirja e masës</b>	226 <sup>1</sup> personat e papunë të evidentuar në APRMV nga grupet qëllimore si më poshtë: të rinj deri 29 vjeç, përfitues të asistencës minimale të garantuar, të papunë që kanë humbur vendet e veta të punës pas shfaqjes së pandemisë COVID-19 (nga marsi 2020) dhe romë
<b>Institucioni kompetent</b>	MPPS, APRMV, RQRMV, DAP, QPS
<b>Shuma e mbështetjes financiare</b>	

Mbështetja e punësimit të ri deri 460.000 denarë, 768.750 denarë, apo 1.000.000 denarë (në varësi nga moshë dhe numri i punësimeve të miratuara).

Shuma e grantit të punësimit të një personi në moshë mbi 29 vjeç arrin 92.000 denarë, për personat deri 29 vjeç, shuma e grantit për një punëmarrës arrin 153.750 denarë, ndërsa për përfitues të asistencës minimale të garantuar dhe për persona të papunë të komunitetit etnik rom, shuma e grantit për një punëmarrës arrin 200.000 denarë, ndërsa për personat e papunë që kanë humbur vendet e veta të punës pas shfaqjes së pandemisë COVID-19 (nga marsi 2020), mbështetja financiare do të arrijë 260.000 denarë.

#### Përfituesit

Ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, ndërmarrjet sociale dhe organizatat e shoqërisë civile, të interesuara për hapjen e vendeve të reja të punës.

Ndërmarrjet e reja të themeluara me anë të Programit të Vetëpunësimit për vitin 2020.

Personat e papunë.

#### Mënyra e aplikimit

Thirrje Publike/Njoftim, Fletëparaqitje, ndërmjetësim dhe kërkim në regjistrat nga punonjësi i Qendrës së Punësimit.

#### Kriteret

**Pjesëmarrja në Program dhe përzgjedhja e punëdhënësve do të bëhet në përputhje me kriteret e mëposhtme:**

- ◆ Numri i përgjithshëm i punëmarrësve me afat të pacaktuar në ditën e aplikimit dhe para realizimit të mbështetjes nuk duhet qenë më i ulët se numri mesatar i punëmarrësve<sup>2</sup> me afat të pacaktuar në vitin paraardhës kalendarik, përveç nëse arsyet e uljes së numrit të punëmarrësve me afat të pacaktuar janë për shkak të përfundimit të marrëdhënies së punës (për shkak të dorëheqjes së punëmarrësit), ushtrimit të së drejtës së pensionit, vdekjes, apo pazotësisë për të vepruar.
- ◆ Ka shlyer të gjitha detyrimet me bazë pagat dhe kontributet e paguara për sigurim të detyrueshëm social;

1. Në kuadrin e kësaj mase, do të insistohet të përfshihen 40 romë

2. Termi “numri mesatar i punëmarrësve” ka të bëjë vetëm me nevojat e zbatimit të programeve/masave aktive të punësimit

- ◆ Të mos ketë humbje financiare në vitin paraardhës, përveç nëse humbja është bërë për shkak të investimeve kapitale nga subjekti juridik<sup>1</sup>
- ◆ Punëdhënësi duhet të ketë të paktën një punëmarrës me afat të pacaktuar, me përjashtim të organizatave të shoqërisë civile, të cilat në kohën e aplikimit nuk kanë punëmarrës;
- ◆ Numri i personave të sapopunësuar nuk mund të jetë më i lartë se 50% të numrit mesatar të punëmarrësve me afat të pacaktuar në vitin paraardhës kalendarik, ku numri maksimal nuk mund të jetë më i lartë se 5 persona tek një punëdhënës. Te punëdhënësi që ka punësuar një person, organizatat e shoqërisë civile dhe subjektet e regjistruara pas datës 01.07.2020 që nuk kanë asnjë punëmarrës, numri maksimal i punësimeve që mbështeten është një person.

### Detyrimet

- ◆ Punëdhënësi i cili punëson një person të papunë në kuadrin e këtij Programi, detyrohet ta punësojë këtë person me orar të plotë pune dhe ta mbajë në marrëdhënie pune për të paktën 12 muaj, në qoftë se bëhet fjalë për një person deri 29 vjeç, apo 9 muaj në qoftë se bëhet fjalë për një person mbi 29 vjeç, llogaritur nga dita e lidhjes së marrëdhënies së punës. Në qoftë se personit për të cilin është siguruar mbështetja financiare i pushon marrëdhënia e punës me cilëndo bazë, përveç në rast të vdekjes, pensionimit apo pazotësisë për të vepruar, punëdhënësi detyrohet që brenda 30 ditëve në vendin e tij të punës të punësojë një person tjetër të regjistruar si i papunë, sepse në të kundërt detyrohet ta kthejë shumën e mjeteve financiare proporcionalisht me kohën e mbetur deri në skadimin e afatit.
- ◆ Punëdhënësi detyrohet që gjatë gjithë periudhës së detyrimit të parashikuar të mos ulë numrin e përgjithshëm të punëmarrësve me afat të pacaktuar (të cilin kishte pasur në ditën e aplikimit), përveç në rast të vdekjes, pensionimit apo pazotësisë për të vepruar, sepse në të kundërt detyrohet brenda 15 ditëve të punësojë një person tjetër të papunë - për të plotësuar numrin, sepse në të kundërt, detyrohet të kthejë një shumë proporcionale të mjeteve të paguara financiare (shuma e subvencionit për person, pjesëtuar me numrin e përgjithshëm të muajve).

### Realizimi

- ◆ Thirrje Publike
- ◆ Fletëparaqitje
- ◆ Përzgjedhje
- ◆ Punësim
- ◆ Firmosje e Kontratës së Grantit
- ◆ Pagim të mjeteve financiare për prokurimin e pajisjes së re dhe/ose materialeve

<b>Titulli i masës</b>	<b>2.3 Mbështetja e punësimit të personave me aftësi të kufizuar</b>
<b>Qëllimi i masës</b>	Të rritet kapaciteti dhe mundësitë e punësimit të personave të regjistruar si të papunë dhe me aftësi të kufizuar
<b>Grupi qëllimor</b>	Personat e papunë të regjistruar në APRMV
<b>Shtrirja e masës</b>	210 persona të papunë të regjistruar në APRMV
<b>Institucionet kompetente</b>	APRMV

1.Ky kriter nuk vlen për subjektet juridike që janë regjistruar pas datës 01.07.2020.

## Shuma e mbështetjes financiare

- ◆ **Punësimi i një personi me aftësi të kufizuar me afat të caktuar**, për të cilën jepen 20 paga mesatare neto që paguhen në Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin paraardhës para punësimit, gjegjësisht, 40 paga mesatare neto që janë paguar në Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin ardhës përpara punësimit, nëse bëhet fjalë për një person të verbër apo për një person me aftësi të kufizuar që lëviz me ndihmën e karrocës së invalidëve.
- ◆ **Përshtatja në vendin e punës**, për të cilën jepen mjete financiare në shumë deri 100.000 denarë.
- ◆ **Prokurimi i pajisjes**, për të cilën jepen mjete financiare në shumë deri 200 paga mesatare që paguhen në Republikën e Maqedonisë së Veriut në vitin paraardhës, ku kriteri bazë për shumën e mjeteve financiare të dhëna është numri i punëmarrësve me aftësi të kufizuar.
- ◆ **Asistenti i punës i personit me aftësi të kufizuar**, i cili është përfshirë me aftësimin, në bazë të kërkesës së tij, apo të kërkesës së punëdhënësit.
- ◆ **Aftësimi për punë** i personave me aftësi të kufizuar punëmarrës dhe të papunë.

## Përfituesit

- ◆ Personat me aftësi të kufizuar, të cilët në mënyrë të mëvetësishme kryejnë veprimtari si tregtar i vetëm, punëdhënës, apo kanë cilësinë e punëdhënësit.
- ◆ Shoqëritë tregtare për punësimin e personave me aftësi të kufizuar - shoqëritë mbrojtëse.
- ◆ Administrata shtetërore.
- ◆ Njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe Qyteti i Shkupit.
- ◆ Ndërmarrjet publike, agjencitë, fondet dhe institucionet e tjera shtetërore.

## Mënyra e aplikimit

Konform Ligjit të Punësimit të Personave me Aftësi të Kufizuar ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 44/2000, 16/2004, 62/2005, 113/2005, 29/2007, 88/2008, 161/2008, 99/2009, 136/2011, 129/2015, 147/2015, 27/2016 dhe 99/2018) dhe Rregullores për Kriteret dhe Mënyrën e Dhënies së Mjeteve Financiare të Pakthyeshme nga Fondi i Posaçëm ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 156/2008 dhe 163/2015).

Kërkesën për ndarjen e mjeteve financiare të pakthyeshme nga **Fondi i Posaçëm** përfituesi e paraqet te Bordi Drejtues i Agjencisë së Punësimit e Republikës së Maqedonisë së Veriut, përmes Qendrës së Punësimit në territorin e së cilës gjendet selia e punëdhënësit.

## Kriteret

Kriteret përkufizohen me Rregulloren për Kriteret dhe Mënyrën e Dhënies së Mjeteve Financiare të Pakthyeshme nga Fondi i Posaçëm për përmirësimin e kushteve të punësimit dhe punës së personave me aftësi të kufizuar ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 156/2008 dhe 163/2015).

## Detyrimet

- ◆ Në punësimin e një personi me aftësi të kufizuar, përfituesi i mjeteve financiare detyrohet të krijojë kushte përkatëse të punës dhe përshtatje të vendit të punës, në varësi nga vendi i punës, lloji dhe shkalla e arsimit dhe lloji dhe shkalla e aftësisë së kufizuar të personit me aftësi të kufizuar që punësohet;
- ◆ Përfituesi i mjeteve financiare nga Fondi i Posaçëm nuk guxon ta ulë numrin e përgjithshëm të punëmarrësve me aftësi të kufizuar, për punësimin e të cilëve shfrytëzohen mjete financiare të pakthyeshme (brenda një afati 3 vjeçar nga dita e punësimit të personit me aftësi të kufizuar, për të cilin janë shfrytëzuar mjete financiare në bazë të punësimit, përveç nëse ndërprerja është me fuqi ligji, ose në rast vdekjeje, apo kanë kaluar 3 vjet nga dita e dhënies së mjeteve financiare për prokurimin e pajisjes);
- ◆ Përfituesi i mjeteve financiare detyrohet që punëmarrësve me aftësi të kufizuar rregullisht t'ua paguajë pagën në pajtim me ligjin, marrëveshjen kolektive dhe me kontratën e punës dhe
- ◆ Personat me aftësi të kufizuar duhet të punojnë në një vend përkatës pune, në pajtim me udhëzimet.

## Realizimi

- ◆ Bordi Drejtues i Agjencisë së Punësimit sjell një vendim për dhënien e mjeteve financiare nga Fondi i Posaçëm në bazë të kërkesës së paraqitur brenda 90 ditëve nga dita e paraqitjes së kërkesës;
- ◆ Në bazë të vendimit të sjellë, hartohet një kontratë për pagimin e mjeteve financiare të lëshuara nga Fondi i Posaçëm, dhe
- ◆ Pas dorëzimit të garancisë bankare nga përfituesi i mjeteve financiare, bëhet pagimi i mjeteve të lëshuara financiare.





### 3. TRAJNIMET

Trajnimet e kanë për qëllim përmirësimin e shkathtësive dhe kualifikimeve të personave të papunë për integrimin e tyre më të suksesshëm në tregun e punës.

<b>Titulli i masës</b>	<b>3.1 Trajnimi në vendin e punës për një punëdhënës të njohur</b>
<b>Qëllimi i masës</b>	Kjo masë synon përfitimin e shkathtësive të personave të papunë për kryerjen e detyrave të punës konform nevojave të punëdhënësit
<b>Grupi qëllimor</b>	Personat e papunë që janë regjistruar në APRMV
<b>Shtrirja e masës</b>	152 <sup>1</sup> personat e papunë të regjistruar në APRMV (72 persona të papunë me mbështetjen e projektit E4E@mk, 80 persona të papunë përfitues të GMP-IPA II - granti i katërt i drejtpërdrejtë).
<b>Institucioni kompetent</b>	APRMV, RQRMV, DAP, Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim - Projekti Arsimit për Punësim në Maqedoninë e Veriut (E4E@mk), Dhomat Ekonomike, shoqatat, etj.

#### Shuma e mbështetjes financiare

**Personat që do të ndjekin trajnim** do të marrin shpërblim mujor prej **9.000 denarësh**, përfshirë dhe sigurimin për invaliditet dhe dëmtim trupor, të shkaktuar me dëmtim në vendin e punës dhe sëmundje profesionale, si dhe tatimin mbi të ardhurat personale gjatë trajnimit deri në 3 muaj. Shpërblimet për personat e papunë do të paguhen nga APRMV.

**Punëdhënësit** do t'i paguhet një shumë e njëhershme nga **15.000 denarë** për person të trajnuar, pas përfundimit të trajnimit.

#### Përfituesit

Personat e papunë të regjistruar në APRMV.  
Punëdhënësit.

#### Mënyra e aplikimit

##### Për punëdhënësit:

Thirrje Publike/Njoftim, Fletëparaqitje për Pjesëmarrje në Program, Program Trajnimi

##### Për personat e papunë:

Njoftim, Kërkim në regjistrat e të papunëve me bazë profilimi dhe PIP.

#### Kriteret

##### Për punëdhënësit:

- ◆ Punëdhënësi duhet të ketë punësuar të paktën një person me afat të caktuar, me përjashtim të organizatave të shoqërisë civile dhe punëdhënësve që do të përfshijnë në trajnim gra të komunitetit etnik rom;
- ◆ Në ditën e aplikimit ka shlyer të gjitha detyrimet me bazë pagat dhe kontributet e paguara për sigurim të detyrueshëm social dhe
- ◆ Numri i personave të përfshirë me trajnim nuk mund të jetë më i lartë se 50% të numrit të përgjithshëm të punëmarrësve me afat të caktuar, me përjashtim të organizatave të shoqërisë civile dhe punëdhënësve që do të përfshijnë në trajnim gra të komunitetit etnik rom.

##### Për personat e papunë:

- ◆ Me kualifikime të ulëta

1. Në kuadrin e kësaj mase do të insistohet të përfshihen 15 romë.

## **KOMBINIMI ME MASA TË TJERA**

Pas përfundimit të pjesëmarrjes në masë, të papunët që nuk do të punojnë do të fitojnë mundësinë të përfshihen në programe dhe masa të tjera të Planit Operacional.

Punëdhënësi që do të punësojë më tepër se 50% të personave që kanë ndjekur trajnim, për ata persona do të mund t'i shfrytëzojë mjetet nga Programi 2, konform kritereve të përcaktuara.

### **Detyrimet**

#### **Për punëdhënësit:**

- ◆ Punëdhënësi detyrohet ta zbatojë programin e trajnimit, në përputhje me një plan të paracaktuar për atë;
- ◆ Punëdhënësi detyrohet të caktojë një mentor për personat në trajnim;
- ◆ Punëdhënësi detyrohet të punësojë të paktën 50%<sup>1</sup> të personave të përfshirë me trajnim me orar të plotë pune, për të paktën 3 muaj. Në qoftë se punëdhënësi nuk lidh marrëdhënie pune me të paktën 50% të personave të përfshirë që me sukses kanë kryer trajnimin ose në qoftë se atyre pas lidhjes së marrëdhënies së punës për një periudhë deri 3 muaj u përfundon marrëdhënia e punës, përveç në rast të vdekjes, pensionimit apo pazotësisë për të vepruar, ai detyrohet të punësojë një person tjetër të papunë nga rendi i personave që kanë kryer trajnimin me sukses, apo ndonjë person tjetër të regjistruar si i papunë;
- ◆ Gjatë trajnimit dhe periudhës për të cilat punëdhënësi detyrohet ta mbajë personin në punë (6 muaj), punëdhënësi detyrohet mos ta ulë numrin e përgjithshëm të punëmarrësve me afat të pacaktuar, të cilët ka pasur në ditën e aplikimit. Në të kundërt, ai detyrohet ta kthejë shumën e përgjithshme të pranuar;
- ◆ Të drejtat dhe detyrimet janë përshkruar dhe rregullohen me Udhëzimet Operacionale dhe Kontratën.

#### **Për personat e papunë:**

- ◆ Gjatë trajnimit kandidati detyrohet: rregullisht ta ndjekë trajnimin dhe t'i kryejë detyrat e dhëna të punës; në rast të pamundësisë për të paraqitet në vendin e punës - brenda 24 orëve ta informojë punëdhënësin për arsyen e mungesës dhe të sjellë një dokument arsyetimi, sepse në të kundërt, do të përjashtohet nga trajnimi; duhet qenë i disiplinuar dhe duhet ta respektojë rendin e përcaktuar dhe ta respektojë pronën, mjetet e punës dhe me ndërgjegje të trajtojë materialet e besuara; në rast të shkakimit të dëmit gjatë trajnimit, apo për arsye të sjelljes së pandërgjegjshme apo pakujdesisë së skajshme, detyrohet që të zhëdmojë punëdhënësin. E drejta e trajnimit e kandidatit pushon: nëse kandidati me vullnetin e vet lëshon trajnimin; nëse është përjashtuar për shkak të mungesës së paarsyetuar nga trajnimi; në qoftë se shkakton dëm me sjellje të pandërgjegjshme apo pakujdesi të skajshme dhe nëse për shkaqe të arsyeshme (sëmundje, punësim, themelues apo drejtues i një subjekti juridik, shërbim të afatit ushtarak) nuk ka marrë pjesë në të paktën 70% të trajnimit. Përveç në rast se ndërprerja e trajnimit është me arsye, në të gjitha rastet e tjera të numëruara, kandidati fshihet nga regjistrat e të papunëve për një vit. Të papunët që kanë marrë pjesë në minimumin e 70% të orëve të parashikuara për atë muaj u paguhen 9.000 denarë në muaj (duke përfshirë dhe tatimin e të ardhurave personale dhe sigurimin në rast aksidenti në punë dhe sëmundja profesionale);
- ◆ Kandidati që do të kryejë trajnimin dhe të cilit i është ofruar punësimi, detyrohet të lidh marrëdhënie pune me punëdhënësin. Në qoftë se nuk lidh marrëdhënie pune, detyrohet t'i kthejë mjetet, përveç në rastin e punësimit tek një punëdhënësi tjetër;
- ◆ Të drejtat dhe detyrimet janë përshkruar dhe rregullohen me Udhëzimet Operacionale dhe Kontratën.

1. Në qoftë se punëdhënësi ka trajnuar një person, ai e ka për detyrë ta punësojë atë.

## Realizimi

- ◆ Thirrje Publike për Punëdhënësit:
- ◆ Fletëparaqitje për Pjesëmarrje në Trajnim nga punëdhënësit e interesuar
- ◆ Përzgjedhja e punëdhënësve
- ◆ Përzgjedhja e personave të papunë
- ◆ Kontratë me një punëdhënës dhe me një të papunë
- ◆ Trajnimi i të papunëve
- ◆ Punësimi
- ◆ Monitorimi

<b>Titulli i masës</b>	<b>3.2 (a) Trajnim për kualifikime profesionale me kërkesë të punëdhënësve</b>
<b>Qëllimi i masës</b>	Masa synon ofrimin e një trajnimi për kualifikime profesionale të zbatuara nga trajnerë të verifikuar, me kërkesë të punëdhënësve. Trajnimi do të realizohet në bashkëpunim të ngushtë me punëdhënësit dhe ofruesit e trajnimit
<b>Grupi qëllimor</b>	Personat e papunë të regjistruar në APRMV
<b>Shtrirja e masës</b>	100 persona të papunë të regjistruar në APRMV
<b>Institucioni kompetent</b>	MPPS, APRMV, UNDP, SDC, MASH, QARR, punëdhënësit, ofruesit e trajnimit.

### Shuma e mbështetjes financiare

**Personat që do të ndjekin trajnim me masën** do të marrin shpërblim mujor prej **9.000 denarësh**, përfshirë sigurimin e përfshirë në rast aksidenti në vendin e punës dhe tatimin mbi të ardhurat personale gjatë trajnimit, **nga 2 deri 4 muaj**.

Punëdhënësi mund me anë të bashkëfinancimit ta rrisë shumën e pagesave mujore gjatë trajnimit, që do të reflektohet në kontratë në mënyrën përkatëse.

**Ofruesit e trajnimit** do të marrin shpërblim prej **30.000 denarësh** për person që ndjek trajnimin.

### Përfituesit

Personat e papunë të regjistruar në APRMV.  
Punëdhënësit.

### Mënyra e aplikimit

#### Për punëdhënësit:

Thirrje Publike/Njoftim, Fletëparaqitje për Pjesëmarrje në Program

#### Për personat e papunë:

Fletëparaqitje dhe Deklaratë Pëlqimi, Kërkim në regjistrat e të papunëve në bazë të profilimit dhe PIP.

#### Për ofruesit e trajnimit:

Nga regjistri i ofruesve të verifikuar të QARR dhe MASH.

Nga evidenca e MASH për shkollat e mesme profesionale me një program të verifikuar trajnimi.

### Kriteret

#### Për punëdhënësit:

◆ Sigurimi i hapësirave/kapaciteteve, pajisja për realizimin e trajnimit

#### Për ofruesit e trajnimit:

◆ Verifikimi i vlefshëm për realizimin e trajnimit dhe/ose profilin të profesionit nga profesioni i nevojitur

#### Për personat e papunë:

◆ Përzgjedhjen e të papunëve nga regjistrat e APRMV e kryen punëdhënësi

### KOMBINIMI ME MASA TË TJERA

Pas kryerjes së pjesëmarrjes në masë, të papunët kanë mundësi të shfrytëzojnë programe dhe masa të tjera nga Plani Operacional.

### Për ofruesit e trajnimit:

- ◆ Përshtat një program trajnimi për një periudhë nga 2 deri 4 muaj, në pajtim me nevojat e punëdhënësve, program ky i cili do të verifikohet nga QARR dhe MASH;
- ◆ Të papunët të cilët kanë marrë pjesë në të paktën 70% të orëve të parashikuara për atë muaj, paguhen me 9.000 denarë (përfshirë tatimin mbi të ardhurat personale dhe sigurimin në rast aksidenti në punë dhe sëmundjeje profesionale), të siguruara me anë të masës, dhe të përcaktuara në marrëveshjen katërpalëshe për pjesëmarrje në masë, e cila lidhet midis ofruesit të trajnimit, punëdhënësit, APRMV-QP dhe UNDP;
- ◆ Dorëzon raport muaj mbi prezencën e personave, raport mbi rezultatet e realizimit mujor të trajnimeve dhe provën e mjeteve financiare që u janë paguar kandidatëve;
- ◆ Zbaton kontrollin e njohurive të mbledhura përpara Komisionit dhe lëshon dokumentin përkatës të përcaktuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) dhe/ose nga Qendra e Arsimit të Rriturve (QARR) dhe
- ◆ Pas kryerjes së trajnimit, dorëzon te UNDP dhe APRMV një raport përmbledhës dhe vlerësim të trajnimit të realizuar.

### Për personat e papunë:

→ Gjatë trajnimit kandidati detyrohet:

- ◆ Rregullisht ta ndjekë trajnimin dhe t'i kryejë detyrat e punës që i janë dhënë. Në rast të pamundësisë për t'u paraqitur në vendin e punës, duhet brenda 24 orëve ta informojë punëdhënësin për arsyen e mungesës dhe të sjellë dokument arsyetimi. Në të kundërt, do të përjashtohet nga trajnimi;
- ◆ Duhet të jetë i disiplinuar dhe ta respektojë rendin e përcaktuar dhe ta respektojë pronën, mjetet e punës dhe me ndërgjegje të përdor materialet e besuara. Në rast të shkaktimit të dëmit gjatë trajnimit për shkak të sjelljes së pandërgjegjshme apo pakujdesisë së skajshme, detyrohet që ta zhdëmtojë punëdhënësin.

→ E drejta e trajnimit të kandidatit pushon nëse kandidati:

- ◆ Nuk ka ndjekur 70% të trajnimit për arsye të justifikuara (sëmundje, punësim, themelues ose drejtues i një subjekti juridik, shërbim ushtarak);
- ◆ Vullnetarisht lë trajnimin;
- ◆ Përjashtohet për shkak të mungesës së paarsyetuar në trajnim dhe nëse ka bërë dëm për shkak të sjelljes së pandërgjegjshme apo pakujdesisë së skajshme.
  - ◇ Në rast të ndërprerjes së trajnimit, kandidati fshihet nga regjistrat e të papunëve për një periudhë njëvjeçare, përveç nëse është përjashtuar nga trajnimi për arsye të justifikuara;
  - ◇ Pas përfundimit të trajnimit, kandidati hy në provim përfundimtar përpara një Komisioni dhe në qoftë se nuk paraqitet/nuk hy në provimin përfundimtar, detyrohet t'i kthejë mjetet e paguara financiare dhe fshihet nga regjistrat e të papunëve për një vit, dhe
  - ◇ Kandidati që do të kryejë trajnimin dhe të cilit i është ofruar punësimi, detyrohet të lidh marrëdhënie pune me punëdhënësin. Në qoftë se nuk lidh marrëdhënie pune, detyrohet t'i kthejë mjetet financiare, përveç në rast punësimi tek një punëdhënësi tjetër.

## Për punëdhënësit:

- ◆ Përcakton kriteret minimale për përzgjedhjen e personave të papunë;
- ◆ Merr pjesë aktive në realizimin e trajnimit;
- ◆ Në qoftë se është në mundësi, e plotëson/bashkëfinancon shpërblimin mujor për personat e referuar në trajnim, që përkatësisht reflektohet dhe në marrëveshjen katërpalëshe;
- ◆ Pas përfundimit të trajnimit, brenda një afati 3-ditor punëdhënësi detyrohet të punësojë të paktën 50% të personave të përfshirë me trajnimin, me orar të plotë pune, për të paktën 6 muaj. Në qoftë se punëdhënësi nuk lidh marrëdhënie pune me të paktën 50% të personave të cilët me sukses kanë kryer trajnimin, detyrohet t'i kthejë mjetet financiare në shumë totale nga 30.000 denarë për person të papunë e të trajnuar për personat që nuk ka marrë në punë, e të cilët janë përcaktuar me marrëveshjen katërpalëshe, përveç në rast kur ndonjëri nga personat e papunë dhe të trajnuar kanë refuzuar punësimin, dhelf
- ◆ Në qoftë se punëtorit i pushon marrëdhënia e punës përpara skadimit të afatit 6-mujor, punëdhënësi detyrohet të punësojë një të papunë tjetër nga rendi i personave që me sukses kanë kryer trajnimin, apo një person tjetër të regjistruar si i papunë. Në të kundërt, ai detyrohet që mjetet financiare të shfrytëzuara për trajnim në shumë prej 30.000 denarësh për person, t'i kthejë në shumën proporcionale.

## Realizimi

- ◆ Fletëparaqitje për Pjesëmarrjen e Punëdhënësve
- ◆ Përzgjedhja e punëdhënësve
- ◆ Përzgjedhja e ofruesve të trajnimit
- ◆ Njoftim për personat e papunë
- ◆ Përzgjedhja e personave të papunë
- ◆ Trajnimi i personave të papunë
- ◆ Punësimi
- ◆ Monitorimi

<b>Titulli i masës</b>	<b>3.2 (b) Trajnimet profesionale me kërkesë të punëdhënësve</b>
<b>Qëllimi i masës</b>	Masa synon ofrimin e trajnimeve për kualifikime profesionale me kërkesën e punëdhënësve. Trajnimi do të realizohet në bashkëpunim të ngushtë me sektorin privat.
<b>Grupi qëllimor</b>	Personat e papunë të regjistruar në APRMV <sup>1</sup>
<b>Shtrirja e masës</b>	80 persona të papunë të regjistruar në APRMV nga rendi i grupeve vulnerabil
<b>Institucioni kompetent</b>	UNDP-SDC, MPPS, APRMV, MASH, QARR, punëdhënës dhe ofrues trajnimit.

### Shuma e mbështetjes financiare

**Personave që do të ndjekin trajnim për kualifikime profesionale**, do t'u paguhet një shpërblim mujor prej **9.000 denarësh** nga buxheti i masës, përfshirë sigurimin në rast aksidenti në vendin e punës dhe tatimin mbi të ardhurat personale për kohëzgjatjen e trajnimit, **nga 2 deri 4 muaj**. Punëdhënësi mund me anë të bashkëfinancimit ta rrisë shumën e shpërblimeve mujore gjatë trajnimit, që do të reflektohet në kontratë në mënyrën përkatëse.

**Ofruesit e trajnimit për kualifikime profesionale** do të marrin shpërblim prej **30.000 denarësh** për person në trajnim<sup>2</sup>.

### Përfituesit

Persona të papunë të regjistruar në APRMV  
Punëdhënës

### Mënyra e aplikimit

#### Për punëdhënësit:

Thirrje Publike/Njoftim, Fletëparaqitje për Pjesëmarrje në Program

#### Për personat e papunë:

Njoftim, Fletëparaqitje dhe Deklaratë Pëlqimi, kërkim në regjistrat e të papunëve në bazë të profilimit dhe PIP.

#### Ofruesit e trajnimit:

Ofruesit e trajnimit (punëdhënësit)

1. Fokusi i masës bie te grupet e mëposhtme qëllimore: të rinj deri moshën 29 vjeç, persona me aftësi të kufizuar, pjesëtarë të komunitetit rom, dhe persona të tjerë në rrezik nga përjashtimi social.

2 Shuma për trajnimin të cilin po e realizojnë vetë punëdhënësit shënohet në Planin e Trajnimit, dhe ajo nuk mund të kalojë 30.000 denarë për person në trajnim. Plani i Trajnimit dhe mjetet e nevojitura për realizimin e tij i aprovon Organi Punues i ngarkuar me realizimin e masës.

## Kriteret

### Për punëdhënësit:

- ◆ Sigurimi i hapësirave/kapaciteteve, pajisjes për realizimin e trajnimit për kualifikime profesionale

### Për ofruesit e trajnimit për kualifikime profesionale:

- ◆ Profili i profesionit/përvoja e punës nga profesioni i nevojitur

### Për ofruesit e tjerë të trajnimit:

- ◆ Plani i Trajnimit që përfshin dinamikën dhe renditjen e orëve dhe moduleve

## KOMBINIMI ME MASA TË TJERA

Pas kryerjes së pjesëmarrjes në masë, të papunët kanë mundësi të shfrytëzojnë dhe programe dhe masa të tjera nga Plani Operacional.

## Detyrimet

### Për ofruesit e trajnimit për kualifikime profesionale:

- ◆ Përshtat një program trajnimi brenda 2 deri 4 muajve, në përputhje me nevojat e punëdhënësve;
- ◆ Të papunëve që kanë qenë të pranishëm për 70% të orëve të parashikuara, për atë muaj u paguhen 9.000 denarë (përfshirë tatimin mbi të ardhurat dhe sigurimin nga aksidenti dhe sëmundja profesionale), të siguruara me anë të masës, e të përcaktuara me kontratën për pjesëmarrje në masë;
- ◆ Dorëzon raport muaj mbi prezencën e personave, raport mbi rezultatet e realizimit mujor të trajnimeve dhe provën e mjeteve financiare që u janë paguar kandidatëve;
- ◆ Zbaton kontrollin e njohurive të mbledhura edhe pas përfundimit të trajnimit dorëzon në UNDP dhe APRMV një raport përmbledhës dhe vlerësimin e trajnimit të realizuar.

### Për të papunët që ndjekin trajnim për kualifikime profesionale:

→ Përgjatë trajnimit, kandidati detyrohet:

- ◆ rregullisht ta ndjekë trajnimin dhe t'i kryejë detyrat e dhëna të punës. Në rast të pamundësisë për t'u paraqitur në vendin e punës, duhet brenda 24 orëve ta informojë punëdhënësin për arsyen e mungesës dhe të sjellë një dokument arsyetimi, ose në të kundërtën do të përjashtohet nga trajnimi, dhe
- ◆ të jetë i disiplinuar dhe ta respektojë rendin e përcaktuar dhe ta respektojë pronën, mjetet e punës dhe të përdor me ndërgjegje materialet e besuara. Në rast të shkaktimit të dëmit gjatë trajnimit për shkak të sjelljes së pandërgjegjshme apo pakujdesisë së skajshme, detyrohet që ta zhdëmtojë punëdhënësit.

→ E drejta e trajnimit të kandidatit pushon nëse kandidati:

- ◆ nuk ka marrë pjesë në 70% të trajnimit për arsye të justifikuara (sëmundje, punësim, themelues apo drejtues i një subjekti juridik, shërbim të afatit ushtarak);
- ◆ me vullnetin e vet lë trajnimin, dhe
- ◆ është përjashtuar për shkak të mungesës së paarsyetuar nga trajnimi dhe ka bërë dëm për shkak të sjelljes së pandërgjegjshme apo pakujdesisë së skajshme.
- ◆ Në rast të ndërprerjes së trajnimit, kandidati fshihet nga regjistrat e të papunëve në kohëzgjatje njëvjeçare, përveç nëse është përjashtuar nga trajnimi për arsye të justifikuara.
- ◆ Pas përfundimit të trajnimit, kandidati hy në provimin përfundimtar dhe në qoftë se nuk paraqitet/nuk hy në provimin përfundimtar, detyrohet t'i kthejë mjetet financiare të paguara deri në atë moment dhe fshihet nga regjistri i të papunëve për një kohëzgjatje njëvjeçare.
- ◆ Kandidati që do të kryejë trajnimin dhe të cilit i është ofruar punësimi, detyrohet të lidh marrëdhënie pune me punëdhënësin. Në qoftë se nuk hy në marrëdhënie pune, detyrohet t'i kthejë mjetet financiare, përveç në rast të punësimit tek një punëdhënës tjetër.



### **Për punëdhënësit që marrin pjesë në trajnimin për kualifikime profesionale:**

- ◆ Përcakton kriteret minimale për përzgjedhjen e të papunëve;
- ◆ Merr pjesë aktive në realizimin e trajnimit;
- ◆ Punëdhënësi i cili vetë realizon trajnimin, cakton një mentor për pjesën praktike të trajnimit.
- ◆ Në qoftë se është në mundësi, punëdhënësi plotëson/bashkëfinancon shpërblimin mujor për personat e referuar në trajnim, që në mënyrë përkatëse reflektohet dhe në marrëveshjen katërpalëshe.
- ◆ Pas përfundimit të trajnimit e brenda 3 ditëve, punëdhënësi e ka për detyrë të punësojë të paktën 50% të personave të përfshirë me trajnimin, me orar të plotë pune, në kohëzgjatje nga të paktën 6 muaj. Në qoftë se punëdhënësi nuk lidh marrëdhënie pune me të paktën 50% të personave të përfshirë e të cilët me sukses kanë përfunduar trajnimin, ai detyrohet t'i kthejë mjetet financiare në shumë totale prej 30.000 denarësh për person të papunë të trajnuar, përveç në rast se personi i papunë i trajnuar ka refuzuar punësimin;
- ◆ Në qoftë se punëmarrësit i pushon marrëdhëniet e punës përpara skadimit të 6 muajve, punëdhënësi detyrohet që brenda 30 ditëve të punësojë një të papunë tjetër nga rendi i personave që kanë kryer trajnimin me sukses, apo një person tjetër të papunë, sepse në të kundërt, detyrohet që mjetet financiare të shfrytëzuara për trajnimin në shumë deri 30.000 denarë për person, t'i kthejë në një shumë proporcionale.

### **Realizimi**

- ◆ Fletëparaqitja për pjesëmarrje nga punëdhënësi për trajnim në kualifikime profesionale;
- ◆ Përzgjedhja e të papunëve për pjesëmarrje në trajnim për kualifikime profesionale;
- ◆ Përzgjedhja e ofruesve të trajnimit për kualifikime profesionale;
- ◆ Njoftimi për personat e papunë mbi trajnimin për kualifikime profesionale;
- ◆ Përzgjedhja e të papunëve për trajnim në kualifikime profesionale;
- ◆ Trajnimi i personave të papunë, dhe
- ◆ Monitorimi

<b>Titulli i masës</b>	<b>3.2 (c) Trajnime onlajn për shkathtësi me kërkesë të punëdhënësve</b>
<b>Qëllimi i masës</b>	Qëllimi i masës është sigurimi i një trajnimi onlajn për shkathtësi, me kërkesë të punëdhënësve. Trajnimi do të realizohet në bashkëpunim të ngushtë me sektorin privat dhe ofruesit e trajnimit.
<b>Grupi qëllimor</b>	Personat e papunë të regjistruar në APRMV
<b>Shtrirja e masës</b>	100 të papunë të regjistruar në APRMV nga rendi i grupeve vulnerabil <sup>1</sup>
<b>Institucioni kompetent</b>	UNDP-SDC, MPPS, APRMV, MASH, QARR, punëdhënës dhe ofrues trajnimi.

### Shuma e mbështetjes financiare

**Personat që do të ndjekin trajnim onlajn për shkathtësi** do të marrin qasje në trajnime onlajn, konform trendëve dhe kërkesave të tregut të punës.

Shuma e shpërblimit për **Ofruesit e trajnimit onlajn për shkathtësi** do të varet nga specifikat e trajnimit, gjegjësisht nga kohëzgjatja, numri i parashikuar i orëve dhe modulet e trajnimit. Ofruesit e trajnimit do të marrin shpërblim në vlerë deri 70% të çmimit të vlerësuar i tregut, por jo më tepër se 30.000 denarë për person në trajnimet me kërkesë të punëdhënësve dhe tregut të punës, ndërsa bashkëfinancimi i mjeteve financiare do të sigurohet nga punëdhënësi.

### Përfituesit

Persona të papunë të regjistruar në APRMV  
Punëdhënës

### Mënyra e aplikimit

#### Për punëdhënësit:

Thirrje Publike/Njoftim, Fletëparaqitje për Pjesëmarrje në Program

#### Për personat e papunë:

Lajmërim, Fletëparaqitje dhe Deklaratë Pëlqimi, Kërkim në regjistrat e të papunëve me bazë profilimi dhe PIP.

#### Ofruesit e trajnimit:

Ofruesit e tjerë të trajnimit (punëdhënës, portale onlajn, etj.)

### Kriteret

#### Për ofruesit e tjerë të trajnimit:

Plani i Trajnimit i shoqëruar me dinamikën dhe renditjen e orëve dhe moduleve.

#### KOMBINIMI ME MASA TË TJERA

Pas kryerjes së pjesëmarrjes në masë, të papunët kanë mundësi të shfrytëzojnë dhe programe dhe masa të tjera nga Plani Operacional.

1. Fokusi i masës bie te grupet e mëposhtme qëllimore: të rinj deri 29 vjeç, persona me aftësi të kufizuara, pjesëtarë të komunitetit rom dhe persona të tjerë të rrezikuar nga përjashtimi social.

## Detyrimet

### Për ofruesit e trajnimit onlajn për shkathtësi:

- ◆ Paraqet raport mbi rrjedhën e trajnimit, raport mbi rezultatet nga realizimi i trajnimeve;
- ◆ Zbaton kontrollimin e njohurive të mbledhura, dhe
- ◆ Pas përfundimit të trajnimit, dërgon në UNDP dhe APRMV një raport përmbledhës dhe vlerësimin e trajnimit të realizuar.

### Për të papunët që do të ndjekin trajnim onlajn për shkathtësi:

- ◆ Për kohëzgjatjen e trajnimit, kandidati detyrohet rregullisht ta ndjekë trajnimin. Në rast të ndërprerjes së trajnimit, kandidati fshihet nga regjistrat e të papunëve në kohëzgjatje njëvjeçare, përveç nëse është përjashtuar nga trajnimi për arsye të justifikuara.

## Realizimi

- ◆ Fletëparaqitja për pjesëmarrje nga punëdhënës për **trajnime onlajn në shkathtësi**
- ◆ Fletëparaqitja e të papunëve të interesuar për trajnim në shkathtësitë profesionale;
- ◆ Përzgjedhja e ofruesve të trajnimit onlajn;
- ◆ Trajnimi i personave të papunë, dhe
- ◆ Monitorimi.



<b>Titulli i masës</b>	<b>3.3 Trajnime mbi profesionet e kërkuara</b>
<b>Qëllimi i masës</b>	Qëllimi i masës është që përmes trajnimit të përmbushen nevojat për profesionet e kërkuara, shërbimet sociale <sup>1</sup> dhe kualifikimet që çojnë drejt “vendeve të gjelbra të punës”, e-tregtia.
<b>Grupi qëllimor</b>	Personat e papunë të regjistruar në APRMV
<b>Shtrirja e masës</b>	<b>400 Gjithsej<sup>2</sup></b> të papunët e regjistruar në APRMV, nga të cilët 200 persona të papunë - shfrytëzues të GMP, IPA II – granti i katërt i drejtpërdrejtë
<b>Institucioni kompetent</b>	MPPS, APRMV, MASH, QARR dhe ofrues të verifikuar të trajnimeve

### Shuma e mbështetjes financiare

**Personat që do të ndjekin trajnim** do të marrin shpërblime mujore prej **9.000 denarësh** përfshirë sigurimin për invaliditet dhe dëmtim trupor, të shkaktuar nga aksidenti dhe sëmundja profesionale, si dhe tatim mbi të ardhurat personale për kohëzgjatjen e trajnimit.

**Ofruesit e trajnimit** do të marrin shpërblim prej **24.000 denarësh** për person të trajnuar. Trajnimi do të realizohet në kohëzgjatje 3 muajshe. Përparësi për përfshirje me trajnimet do të kenë përfituesit e asistencës minimale të garantuar.

### Përfituesit

Persona të papunë nga evidenca e APRMV

### Mënyra e aplikimit

#### **Për ofruesit e trajnimit:**

Thirrje Publike, Fletëparaqitje për Pjesëmarrje në trajnimet nga ofrues të verifikuar me anë të Thirrjes Publike të shpallur nga QARR dhe/ose regjistri i ofruesve të verifikuar të QARR dhe MASH.

#### **Për personat e papunë:**

Thirrje Publike/Njoftim, kërkim në regjistrat e të papunëve në bazë të profilimit, PIP dhe Plan Individual i Aktivizimit, Fletëparaqitje dhe Deklaratë Pëlqimi.

### Kriteret

#### **Për ofruesit e trajnimit:**

Ofruesi i trajnimit për profesionet e kërkuara duhet poseduar një verifikim të vlefshëm për realizimin e trajnimit.

#### **Për personat e papunë:**

Kualifikimet e përmbushura minimale për ndjekjen e trajnimit.

#### **KOMBINIMI ME MASA TË TJERA**

Pas kryerjes së pjesëmarrjes në masë, të papunët kanë mundësi të shfrytëzojnë dhe programe dhe masa të tjera nga Plani Operacional.

1.Në përputhje me Ligjin e Mbrojtjes Sociale - ata janë asistentë personalë të personave me aftësi të kufizuar dhe dhënës të shërbimeve: të asistencës dhe përkujdesjes në shtëpi - kujdestarët

2.Në kuadrin e kësaj mase, do të insistohet të përfshihen 40 romë

## Detyrimet

### Për ofruesit e trajnimit

- ◆ Zbaton trajnim të verifikuar nga QARR dhe MASH;
- ◆ Paraqet raport mujor mbi prezencën e personave, raport mbi rezultatet e realizimit mujor të trajnimeve;
- ◆ Zbaton kontrollimin e njohurive të përfituara të kandidatëve përpara një Komisioni dhe lëshon një dokument përkatës të parashkruar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) dhe/ose nga Qendra e Arsimimit të Rriturve (QARR);
- ◆ Personave që do ta kalojnë me sukses provimin, u lëshohet një certifikatë e parashkruar nga MASH.
- ◆ Ofruesi i trajnimit dërgon raportin përfundimtar dhe vlerësimin e trajnimit të realizuar.
- ◆ Të drejtat dhe detyrimet janë përshkruar dhe rregullohen me Udhëzimet Operacionale dhe Kontratën.

### Për personat e papunë:

- ◆ Gjatë trajnimit, kandidati detyrohet: rregullisht ta vizitojë trajnimin, në rast të pengimit për të marrë pjesë, brenda 24 orëve ta informojë ofruesin e trajnimit për arsyen e mungesës dhe të sjellë dokument arsyetimi, sepse në të kundërt do të përjashtohet nga trajnimi; të jetë i disiplinuar, ta respektojë rendin e parashkruar dhe ta ruajë pronën, mjetet e punës dhe të trajtojë me ndërgjegje materialet e besuara; në rast të shkaktimit të dëmit gjatë trajnimit për arsye të sjelljes së pandërgjegjshme apo nga pakujdesia e skajshme, detyrohet ta kompensojë atë. Kandidati i cili ndërpret ndjekjen e trajnimit, përkatësisht punën praktike për arsye të pajustificuara fshihet nga regjistrat e të papunëve brenda një viti dhe
- ◆ Të drejtat dhe detyrimet janë përshkruar dhe rregullohen me Udhëzimet Operacionale dhe Kontratën.

## Realizimi

- ◆ Thirrje Publike për Persona të Papunë dhe kërkim në regjistrat e të papunëve me bazë profilimin dhe PIP;
- ◆ Thirrje Publike për Trajnerë;
- ◆ Fletëparaqitje për Pjesëmarrjen e Ofruesve të Trajnimit;
- ◆ Përzgjedhja e ofruesve të trajnimit;
- ◆ Përzgjedhja e personave të papunë;
- ◆ Trajnimi i personave të papunë dhe;
- ◆ Monitorimi.

<b>Titulli i masës</b>	<b>3.4 Trajnime për shoferë në kategorinë C dhe D</b>
<b>Qëllimi i masës</b>	Rritja e kapacitetit të punësimit të personave të papunë të regjistruar duke përfituar shkathtësi, në përputhje me kërkesat në profesionin e trafikut dhe nevojat e shprehura për krah pune në këtë degë ekonomike dhe punësimin e tyre.
<b>Grupi qëllimor</b>	Personat e papunë të regjistruar në APRMV
<b>Shtrirja e masës</b>	50 persona të papunë të evidentuar në APRMV
<b>Institucioni kompetent</b>	MPPS, APRMV, Autoshkolla

### Shuma e mbështetjes financiare

Trajnimet dhe provimet do të realizohen në autoshkolla të licencuara. Trajnimet do të kthehen ndaj profesioneve që kërkohen në tregun e punës në profesionin trafikor, gjegjësisht, do të orientohen drejt përmbushjes së nevojave për shoferët me provim të kaluar të patentës për kategorinë C dhe D tek ofruesit e trajnimeve, të paraqitur në shpallje të rregullt. Ata persona që do ta kryejnë trajnimin me sukses, do të fitojnë të drejtën të hyjnë në provimin e patentës në qendra provimi të licencuara. Trajnimi do të zgjasë një muaj.

### Përfituesit

Persona të papunë të regjistruar në APRMV

### Mënyra e aplikimit

#### Për ofruesit e trajnimit:

Procedura për dhënien e një kontrate të prokurimit publik

#### Për personat e papunë:

Thirrje Publike / Njoftim, kërkim në regjistrat e të papunëve me bazë profilimi dhe PIP, Fletëparaqitje dhe Deklaratë Pëlqimi.

### Kriteret

#### For training providers:

- ◆ Trajnimet do të zbatohen nga autoshkolla të përzgjedhura të licencuara, e pas përfundimit të trajnimit (pjesa teorike dhe praktike), kandidatët e suksesshëm do të hyjnë në provimin e patentës për kategorinë C ose D në qendra provimi të licencuara, për të organizuar dhe zbatuar provimin e patentës së shoferit për këtë kategori.

#### Për personat e papunë:

- ◆ Kualifikimet e përmbushura minimale për ndjekjen e trajnimit.

### KOMBINIMI ME MASA TË TJERA

Pas përfundimit të pjesëmarrjes në masë, të papunët kanë mundësinë të shfrytëzojnë programe dhe masa të tjera nga Plani Operacional.

## Detyrimet

### Për ofruesit e trajnimit

- ◆ Zbaton trajnimin;
- ◆ Dorëzon raportin mujor për prezencën e personave, raportin mbi rezultatet e realizimit mujor të trajnimeve;
- ◆ Kryen kontrollin e njohurive të fituara të kandidatëve para Komisionit dhe lëshon një dokument përkatës;
- ◆ Njerëzve që do të kalojnë me sukses provimin u lëshon certifikatën;
- ◆ Autoskolla e licencuar dërgon një raport përfundimtar në APRMV.

### Për personat e papunë:

- ◆ personat e interesuar për të marrë pjesë në trajnim duhet të gjenden në regjistrat e punëkërkuesve aktivë në APRMV;
- ◆ personat që do të përfshihen me trajnimin për kategorinë C duhet më herët të kenë marrë patentën e shoferit (minimumi 1 vit), të kanë mbushur 21 vjet dhe të kenë patentën e shoferit të vlefshme për kategorinë B,
- ◆ personat që do të marrin pjesë në trajnimin për kategorinë D duhet më herët të kenë marrë patentën e shoferit (minimum 2 vjet), të kanë mbushur 24 vjet dhe të kenë patentën e shoferit të vlefshme për kategorinë C;
- ◆ Pas përfundimit të trajnimit dhe kalimit të provimit, personi i papunë do të marrë një vërtetim për lëshimin e patentë shoferit për kategorinë C ose D, informacion ky që do të futet në dosjen individuale të personit të papunë të regjistruar.
- ◆ Të drejtat dhe detyrimet janë përshkruar dhe rregullohen me Udhëzimet Operacionale dhe Kontratën.

## Realizimi

- ◆ Thirrje Publike për Persona të Papunë dhe kërkim në regjistrat e të papunëve me bazë profilimi dhe PIP;
- ◆ Thirrje Publike për Trajnerë;
- ◆ Fletëparaqitje për Pjesëmarrjen e Ofruesve të Trajnimit;
- ◆ Përzgjedhja e ofruesve të trajnimit;
- ◆ Përzgjedhja e personave të papunë;
- ◆ Trajnimi i personave të papunë;
- ◆ Monitorimi.

## 4. TRAJNIMET PËR ZHVILLIMIN E SHKATHTËSIVE DIGJITALE

<b>Titulli i masës</b>	<b>4.1 Trajnime për shkathtësi të avancuara TI</b>
<b>Qëllimi i masës</b>	Masa synon të azhurnojë aftësitë e të rinjve të papunë në moshën deri 34 vjeç në fushën e teknologjisë së informacionit në mënyrë që të rritet konkurrenca e tyre dhe integrimi më i shpejtë në tregun e punës.
<b>Grupi qëllimor</b>	Të rinjtë e papunë deri në moshën 34 vjeç të regjistruar në APRMV
<b>Shtrirja e masës</b>	300 të papunë të regjistruar në APRMV

### PËRSHKRIMI I MASËS

Trajnimet për shkathtësitë e avancuara në fushën e teknologjive të informacionit do të zhvillohen për paketat e mëposhtme të programeve modulare:

#### 1. Full Stack Java development (60 persona)

Pjesa teorike e paketës programike duhet t'i lejojë kursantët të familjarizohen me programimin e orientuar drejt objektit dhe të fitojnë njohuri se si të zhvillojnë aplikacione të konsolës dhe uebit. Nga ushtrimet praktike, kursantët duhet të mësojnë funksionalitetet dhe mundësitë kryesore të gjuhës programike JAVA dhe të kualifikohen si zhvillues (developers) të Full Stack Java.

Paketa programike Full Stack Java development parashikon 3 module trajnimi [Java Fundamentals SE8 (40 orë); Java Programming SE8 (40 orë), MySQL for Developers (32 orë)] dhe marrjen e 1 provimi (1Z0-808) për të fituar titullin OCA, Java SE8 Programmer.

#### 2. Front-end MERN Stack Development (60 persona)

Paketa programike duhet t'u mundësojë kursantëve të mësojnë se si të krijojnë aplikacione dhe shërbime në internet.

Theksi duhet të vihet në programimin e një faqeje të klientit, me përdorimin e standardeve më të fundit për shfaqjen dhe organizimin e informacionit përmes HTML5 dhe CSS3 dhe përdorimin e funksionaliteteve të shfletuesve përmes Java Script.

Paketa programike duhet të mbulojë një nga platformat më të përdorura Node.js bazuar në mekanizmin V8 Java Script dhe bazën e të dhënave Mongo DB. Kursantët do të mund të ndërtojnë ndërfaqe (interface) të përdoruesve më të fundit duke përdorur bibliotekën React – Java Script.

Paketa programike Front-end MERN Stack Development ofron 3 module trajnimi [20480C: Programing in HTML5 with Java Script and CSS3 (40 orë); Node.js & Mongo DB (30 orë) dhe React.js (30 orë)] dhe 1 provim (70-480) për të fituar titullin Programing in HTML5 me Java Script and CSS3.

#### 3. Data analyst (60 persona)

Paketa programike duhet t'u mundësojë kursantëve të njihen me:

- ◆ teknikat për të shkruar një "SELECT statement" bazë për të nxjerrë të dhëna nga "serveri SQL"
- ◆ teknikat e klasifikimit dhe grupimit të të dhënave
- ◆ aplikimi i funksioneve aggregate dhe
- ◆ mënyra e prezantimit të të dhënave.

Për më tepër, kursantët duhet të fitojnë aftësi TI për analizën e të dhënave në Excel, të krijojnë grafikë, të përdorin Pivot Charts dhe të krijojnë Datamodel në Excel. Përveç shkathtësive të mësipërme, kursantët do të kenë mundësinë të njihen me mjetin më të njohur të analizës së të dhënave - Power BI dhe të mësojnë të aplikojnë tërë lifecycle për analizë, duke filluar nga përgatitja e të dhënave, krijimi i Data Model, vizualizimi dhe nxjerrja e konkluzioneve.

Në procesin e të mësuarit, kursantët duhet të njihen me mënyrën e punës së shkathët në ekipe.

Paketa programike Data analyst ofron 4 module trajnimi: [(5532: Writing Analytical Queries for business intelligence (24 orë); 20779: Analyzing Data with Excel (24 orë); 20778: Analysing Data with Power BI (24 orë) dhe Scrum master certified (20 orë)] dhe 2 provime (70-779, 70-778) për të fituar titullin MCSA: BI Reporting.



#### **4. Automation tester (24 persona)**

Pjesa teorike e paketës programike duhet t'u mundësojë kursantëve:

- ◆ mësuarjen e praktikave të programimit të orientuar drejt objektit, i cili më vonë do të jetë baza për shkrimin e skripteve në procesin e testimit të automatizuar dhe
- ◆ të sigurojnë njohuritë e nevojshme për profesionin e testuesit të softuerit, gjegjësisht, të njihen me parimet, fazat, nivelet dhe llojet e testimit, testimin funksional dhe jofunksional, testimin statik dhe dinamik, testimin blackbox dhe whitebox, dizajnimin e rasteve efikase të testimit, duke
- ◆ kryer të njëjtën gjë, duke shkruar raporte të hollësishme të defekteve dhe testime exploratory.

Me të aplikuarit e pjesës praktike të testimit automatik të aplikacioneve në internet, kursantët duhet të fitojnë pavarësi në krijimin e testeve të automatizuara me Selenium Web Driver pa mbikëqyrje.

Paketa programike për Automation tester përfshin 3 module trajnimi [Java Fundamentals (40 orë); ISTQB Foundation (24 orë) dhe A4Q Selenium Tester Foundation (24 orë)] dhe 1 provim (CTFL-001) për titullin ISTQB Foundation Tester.

#### **5. UX design specialist (24 persona)**

Paketa programike UX Design Specialist duhet të përfshijë teknologjitë e reja për dizajnimin e një ueb faqeje dhe aplikacioni që plotësisht përshtatet. Kursantët duhet të mësojnë se si të krijojnë një strategji produkti bazuar në përvojën e përdoruesit, të përcaktojnë funksionalitetet dhe ndërveprimin e ndërfaqes (interface) së përdoruesit, të zhvillojnë një prototip të një ueb projekti dhe të testojnë idenë.

Paketa e softuerit për UX design specialist parashikon 6 module trajnimi [Web design process - përfshirë Creative Thinking (24 orë); Parimet e përdoruesit UX/UI - përfshirë dhe Adobe XD (30 orë); Adobe Animate + ACA Exam (30 orë); optimizimi dhe analitika ueb (30 orë); SCRUM Master Certified (20 orë) dhe dizajnimi i ueb faqes - lëndë praktike (24 orë)] dhe 1 provim (ACA\_701) për përfitimin e titullit Adobe Certified Associate in Multiplatform Animation using Adobe Animate CC 2018.

#### **6. ISTQB software tester (24 persona)**

Kjo paketë programike është menduar për ata që duan të futen në parimet e testimit për të mbështetur procesin e zhvillimit të aplikimit në projekte të shkathëta.

Pjesa teorike e paketës së programit duhet t'u mundësojë kursantëve të njihen me bazat e teknikave dinamike dhe statike për testimin e zgjidhjeve softuerike, si dhe procesin e planifikimit të testimit dhe mjetet e përdorura për atë qëllim. Testimi manual përshtatet më së miri me skenarët e testimit exploratory dhe error guessing.

Pjesa praktike e paketës së programit duhet t'u mundësojë kursantëve të marrin njohuri në lidhje me konceptin e testimit të zgjidhjeve softuerike në një mjedis të shkathët, duke punuar në një ekip të shkathët, me theks të veçantë në rëndësinë e testuesit dhe bashkëpunimin me anëtarët e tjerë të ekipit të shkathët, për përfundimin me sukses të një projekti.

Paketa programike për ISTQB software tester parashikon 3 module trajnimi [ISTQB Software Testing Foundation (24 orë); ISTQB Foundation Extension Agile Tester (16 orë) dhe Scrum Master Certified (20 orë)] dhe 2 provime: CTFL-001 për fitimin e titullit ISTQB Foundation Tester dhe CTFL-AT për fitimin e titullit ISTQB AgileTester.

## 7. Cloud Administrator (24 persona)

Qëllimi i paketës programike është të mësojë bazat e dizajnit dhe implementimit të TI, infrastrukturës së platformës më të përdorur AWS Cloud. Në mënyrë që të integrohen shërbimet AWS në zgjidhjet e bazuara në Cloud, kursantët duhet të kenë njohuri edhe në fushën e administrimit të sistemeve kompjuterike, dizajnimin, implementimin dhe mirëmbajtjen e rrjeteve kompjuterike. Veç kësaj, kursantët duhet të optimizojnë praktikisht modelet AWS Cloud për zgjidhje optimale të TI në një kompani.

Paketa programike për ISTQB software tester parashikon 3 module trajnimi [CCNA – Implementing and Administering Cisco Solutions (40 orë); ISTQB Foundation Extension Agile Tester (16 orë); Scrum Master Certified (20 orë) dhe Puna në një projekt real me mentorim (30 orë)] dhe 2 provime: CTFL-001 për fitimin e titullit ISTQB Foundation Tester dhe CTFL-AT për fitimin e titullit ISTQB Agile Tester.

## 8. Python Developer (24 persona)

Qëllimi i paketës programike është të konfigurujë desktopin e Python në mënyrë të pavarur dhe të kryejë operacione me lloje të ndryshme të të dhënave dhe strukturave. Për më tepër, kursantët do të njihen me funksionimin dhe përdorimin e bazave të të dhënave, gjetjen dhe trajtimin e gabimeve, leximin dhe shkrimin e kodit. Kjo pasohet nga zbatimi i njohurive të fituara më parë në programe më të mëdha, shkrimi i metodave klasore dhe krijimi i testeve në Python. Dëgjuesit do të njihen me platformën Django dhe bazat e web development në të, duke krijuar aplikacionin e parë ueb.

### Institucioni kompetent

MPPS, APRMV, MSHIA dhe ofrues të licencuar të trajnimeve

### Shuma e mbështetjes financiare

**Ofruesit e trajnimit** do të marrin shpërblim në shumën e çmimit të shënuar në ofertën e ofertuesit më të favorshëm, për llojet e mësipërme të trajnimeve.

### Përfituesit

Persona të papunë të regjistruar në APRMV

### Mënyra e aplikimit

#### **Për ofruesit e trajnimit:**

Procedura për dhënien e një kontrate të prokurimit publik

#### **Për personat e papunë:**

Thirrje Publike, Njoftim, kërkim në regjistrat e të papunëve me bazë profilimi dhe PIP, Fletëparaqitje dhe Deklaratë Pëlqimi

### Kriteret

#### **Për ofruesit e trajnimit:**

T'i përmbushin kriteret e përcaktuara me dokumentacionin e tenderit

#### **Për personat e papunë:**

Kualifikimet e përmbushura për ndjekjen e trajnimit

### **KOMBINIMI ME MASA TË TJERA**

Pas përfundimit të pjesëmarrjes në masë, të papunët që nuk do të marrin punë, do të kenë mundësinë e shfrytëzimit të programeve dhe masave të tjera nga Plani Operacional.

## Detyrimet

### **Për personat e papunë:**

- ◆ Ndjekja e rregullt e trajnimit;
- ◆ Personi i cili ndërpret ndjekjen e trajnimit për arsye të pajustificuara fshihet nga regjistrat e të papunëve brenda një viti;
- ◆ Të drejtat dhe detyrimet janë përshkruar dhe rregullohen me Udhëzimet Operacionale dhe Kontratën;
- ◆ Hyrja në provim për një certifikatë të akredituar. Në rast se personi nuk e kalon provimin, ai / ajo ka të drejtë të hyjë përsëri në provim, me shpenzimet vetjake.

### **Për ofruesit e trajnimit:**

- ◆ Të bëjë një kontroll paraprak të nivelit të njohurive të kandidatëve në mënyrë që të përfshihen në trajnim;
- ◆ Të bëjë një përzgjedhje të kandidatëve para fillimit të trajnimit bazuar në kriteret e përcaktuara në udhëzimet operacionale dhe Thirrjen Publike;
- ◆ Ta zbatojë trajnimin;
- ◆ Të lëshojë një certifikatë për trajnim të ndjekur rregullisht dhe një certifikatë të akredituar për provimin e kaluar me sukses.

## Realizimi

- ◆ Thirrje Publike për Personat e Papunë nga regjistrat e të papunëve - me bazë profilimi dhe PIP;
- ◆ Procedurë për dhënien e një kontrate të prokurimit publik;
- ◆ Përzgjedhja e ofruesve të trajnimit;
- ◆ Kontrollimi i nivelit të njohurive të kandidatëve për t'u përfshirë në trajnim;
- ◆ Trajnimi i personave të papunë në Shkup dhe në rajonet e tjera planore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në një periudhë maksimale prej 4 (katër) muajsh nga dita e formimit të rang-listave përfundimtare, në grupe me të paktën 10 (dhjetë) kursantë për paketë programike, e në varësi të interesit të shprehur të kategorisë së synuar të të papunëve të regjistruar për pjesëmarrje në masë;
- ◆ Lëshimi i certifikatës për trajnimin e ndjekur rregullisht (70% të orëve);
- ◆ Hyrja në provim(e) për certifikim zyrtar të akredituar në fushën përkatëse;
- ◆ Lëshimi i certifikatës për provimin/provimet e(të) dhënë(a) me sukses;
- ◆ Monitorimi.

<b>Titulli i masës</b>	<b>4. 2 Trajnime për shkathtësi të avancuara të TI (me bashkëfinancim) për trajnerë të palicencuar</b>
<b>Qëllimi i masës</b>	Masa synon të azhurnojë shkathtësitë e të papunëve me minimum arsim të mesëm në fushën e teknologjive të informacionit në mënyrë që të rritet konkurrueshmëria e tyre dhe integrimi i tyre më i shpejtë në tregun e punës.
<b>Grupi qëllimor</b>	Personat e papunë me minimum arsim të mesëm, të regjistruar në APRMV
<b>Shtrirja e masës</b>	100 të papunë të regjistruar në APRMV
<b>Përshkrimi i masës</b>	

Trajnimet për shkathtësitë e avancuara TI, me bashkëfinancim, do të zbatohen për paketat e mëposhtme të programeve modulare:

### **1. MARKETINGU DIGJITAL (40 persona)**

Programi do të mbulojë shkathtësitë dhe modulet e mëposhtme:

- ◆ Introduction to Digital Marketing
- ◆ Integrated Marketing Communications
- ◆ Digital Marketing Strategy
- ◆ Social Media Management (Facebook, Instagram, Twitter)
- ◆ Social Media Advertising (Facebook & Instagram Ads)
- ◆ Google Ad
- ◆ Marketing Analytics (Google Analytics)
- ◆ Search Engine Optimization
- ◆ Lead Generation
- ◆ E-mail marketing
- ◆ Content marketing

Në të gjitha modulet është parashikuar puna praktike, për të përvetësuar shkathtësitë në mënyrë efektive. Trajnimi parashikon dhe krijimin e një projekti përfundimtar - strategjia e plotë e marketingut. Numri i nevojshëm i orëve për realizimin e trajnimit arrin 150 orë.

### **2. DIZAJNI GRAFIK (30 persona)**

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të fitojnë njohuri për të filluar një karrierë si dizajnerë grafikë.

Programi do të mbulojë aftësitë dhe modulet e mëposhtme:

- ◆ Hyrje në dizajnin grafik
- ◆ Adobe Illustrator
- ◆ Adobe Photoshop
- ◆ Adobe In Design
- ◆ Tipografia
- ◆ Dizajni i logos
- ◆ Layout Design (dizajni i një libri, publikimi, reviste, kopertine, fletushke / broshure)
- ◆ Dizajni i afishes
- ◆ Dizajni i paketimit (prerje shtypi, ofset, klishe, resurse)
- ◆ Creative Thinking
- ◆ UX/UI Design

Në të gjitha modulet është parashikuar puna praktike, për të përvetësuar shkathtësitë në mënyrë efektive. Trajnimi parashikon dhe krijimin e një projekti përfundimtar - krijimi i plotë i markës. Numri i nevojshëm i orëve për realizimin e trajnimit arrin 190 orë.

### 3.WORD PRESS DEVELOPMENT (30 persona)

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të fitojnë shkathtësitë e nevojshme për të filluar një karrierë si zhvillues të Word Press (Word Press developers). Programi do të mbulojë shkathtësitë dhe modulet e mëposhtme:

- ◆ Word Press Admin
- ◆ HTML/CSS
- ◆ Java Script/jQuery/AJAX
- ◆ PHP
- ◆ Baza të të dhënave (MySQL)
- ◆ GIT
- ◆ Custom Word Press Themes
- ◆ Custom Word Press Plugin
- ◆ Advanced Word Press Admin

Në të gjitha modulet është parashikuar puna praktike, për të përvetësuar shkathtësitë në mënyrë efektive. Numri i nevojshëm i orëve për realizimin e trajnimit arrin 226 orë.

#### Institucioni kompetent

MPPS, APRMV, MSHIA dhe ofrues të palicencuar të trajnimeve

#### Shuma e mbështetjes financiare

Ofruesit e trajnimit do të marrin shpërblim nga 49% të çmimit të vlerësuar të tregut për llojet e mësipërme të trajnimeve, ndërsa 51% të mjeteve financiare do të mbulohen nga vetë ofruesi i trajnimit

#### Përfituesit

Persona të papunë të regjistruar në APRMV

#### Mënyra e aplikimit

##### Për ofruesit e trajnimit:

- ◆ Thirrje Publike

##### Për personat e papunë:

- ◆ Thirrje Publike, Njoftim, kërkim në regjistrat e të papunëve me bazë profilimi dhe PIP, Fletëparaqitje dhe Deklaratë pëlqimi

#### Kriteret

##### Për ofruesit e trajnimit:

- ◆ T'i përmbushin kriteret e përkufizuara me Thirrjen Publike For unemployed persons:

##### Për personat e papunë:

- ◆ Kualifikimet e përmbushura për ndjekjen e trajnimit

#### KOMBINIMI ME MASA TË TJERA

Pas përfundimit të pjesëmarrjes në masë, të papunët që nuk do të marrin punë, do të kenë mundësinë e shfrytëzimit të programeve dhe masave të tjera nga Planit Operacional.

#### Detyrimet

##### Për personat e papunë:

- ◆ Ndjekja e rregullt e trajnimit;
- ◆ Nënshkrimi i një marrëveshjeje me ofruesin e trajnimit që pas trajnimit të pranojë punësimin e ofruar me punëdhënës të tjerë;
- ◆ Një person i cili ndërpret ndjekjen e trajnimit për arsye të pajustificuara fshihet nga regjistrat e të papunëve për një vit;
- ◆ Të drejtat dhe detyrimet janë përshkruar dhe rregullohen me Udhëzimet Operacionale dhe Kontratën;
- ◆ Hyrja në provim. Në rast se personi nuk e kalon provimin, ai / ajo ka të drejtë të hyjë në provim me shpenzimet e tij / saj.

## **Për ofruesit e trajnimit:**

- ◆ Të bëjë një kontroll paraprak të nivelit të njohurive të kandidatëve në mënyrë që të përfshihen në trajnim;
  - ◆ Të bëjë një përzgjedhje të kandidatëve para fillimit të trajnimit;
  - ◆ Ta zbatojë trajnimin;
  - ◆ Të lëshojë një certifikatë për trajnim të ndjekur rregullisht dhe një diplomë për provim të dhënë me sukses;
  - ◆ Për një minimum prej 50% të kursantëve që do të përfundojnë me sukses trajnimin, ofruesi i trajnimit do të detyrohet të sigurojë punësim me punëdhënës të tjerë jo më vonë se 12 muaj pas përfundimit të trajnimit.
- Nëse nga 50 punësime të detyrueshme, që është ekuivalente me 50%, ofruesi i trajnimit punëson nga 1 deri në 30 persona, ai do të jetë detyrohet të kthejë 40% të mjeteve financiare të investuara nga APRMV, për personat e tjerë për të cilët kishte qenë e nevojshme të sigurohej punësimi.
- Nëse nga 50 punësime të detyrueshme, që është ekuivalente me 50%, ofruesi i trajnimit punëson nga 31 deri në 40 persona, ai do të detyrohet të kthejë 30% të mjeteve financiare të investuara nga APRMV, për personat e tjerë për të cilët kishte qenë e nevojshme të sigurohej punësimi.
- Nëse nga 50 punësime të detyrueshme, që është ekuivalente me 50%, ofruesi i trajnimit punëson nga 41 deri në 49 persona, ai do të detyrohet të kthejë 20% të mjeteve financiare të investuara nga APRMV, për personat e tjerë për të cilët kishte qenë e nevojshme të sigurohej punësimi.
- ◆ Nëse nga 50 punësime të detyrueshme, që është ekuivalente me 50%, ofruesi i trajnimit nuk punëson asnjë person, ai do të detyrohet t'i kthejë mjetet financiare të investuara nga APRMV, për personat për të cilët kishte qenë e nevojshme të sigurohej punësimi.

## **Realizimi**

- ◆ Thirrje Publike për Persona të Papunë dhe kërkim në regjistrat e personave të papunë me bazë profilimi dhe PIP;
- ◆ Thirrje Publike për zbatimin e trajnimit;
- ◆ Fletëparaqitje për Pjesëmarrjen e Ofruesve të Trajnimit;
- ◆ Përzgjedhja e ofruesve të trajnimit, e kryer nga Komisioni i Përzgjedhjes;
- ◆ Kontrollimi i nivelit të njohurive të kandidatëve për t'u përfshirë në trajnim;
- ◆ Trajnimi i personave të papunë në Shkup dhe në rajonet e tjera planore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në një periudhë maksimale prej 4 (katër) muajsh nga dita e formimit të rang-listës përfundimtare, në grupe me të paktën 10 (dhjetë) kursantë për paketën programike dhe në varësi të interesit të shprehur të kategorisë së synuar të të papunëve të regjistruar për pjesëmarrje në masë;
- ◆ Lëshimi i certifikatës për trajnimin e ndjekur rregullisht (70% të orëve);
- ◆ Hyrja në provim(e) dhe lëshimi i diplomës për provim(e) të kaluar(a) me sukses;
- ◆ Monitorimi;
- ◆ Punësimi.



## 5. PUNË PRAKTIKE

<b>Titulli i masës</b>	<b>5. Punë praktike</b>
<b>Qëllimi i masës</b>	Përfitimi i njohurive praktike të punës dhe shkathtësive të nevojitura për kryerjen e detyrave të punës në vende të caktuara pune
<b>Grupi qëllimor</b>	Persona të papunë deri 34 vjeç me minimum arsimim të mesëm
<b>Shtrirja e masës</b>	1413 të papunë të regjistruar në APRMV, nga të cilët 75 persona do të jenë me mbështetjen e UNDP-SDC dhe 40 persona do të jenë me mbështetjen e IPA - granti i katërt i drejtpërdrejtë
<b>Institucioni kompetent</b>	APRMV, MPPS, UNDP-SDC

### Shuma e mbështetjes financiare

Personat që do të përfshihen në punë praktikë do të marrin shpërblim mujor prej **9.000 denarësh** (përfshirë sigurimin nga invaliditeti dhe dëmtimi trupor të shkaktuar nga dëmtimi në punë dhe sëmundja profesionale dhe tatimi mbi të ardhurat personale) për një periudhë deri në 3 muaj

### Përfituesit

- Persona të papunë deri 34 vjeç me minimum arsimim të mesëm
- Punëdhënës nga sektori privat dhe ai civil

### Mënyra e aplikimit

#### Për punëdhënësit:

Thirrje Publike/Njoftim, Fletëparaqitje për Pjesëmarrje në Masë

#### Për personat e papunë:

Njoftim, kërkim në regjistrat e të papunëve me bazë profilimi dhe PIP dhe Plan i hartuar i Aktivizimit, Fletëparaqitje dhe Deklaratë Pëlqimi.

### Kriteret

#### Për punëdhënësit:

- ◆ Përgatitja e një plani trajnimi për praktikantin, me detyrat dhe aktivitetet e numëruara të punës;
- ◆ Punëdhënësi duhet të ketë të paktën një punëmarrës me afat të pacaktuar, të paktën 6 muaj para aplikimit, me përjashtim të organizatave të shoqërisë civile dhe angazhimin e grave rrome si praktikante;
- ◆ Punëdhënësi duhet të caktojë një mentor për praktikantin i cili do ta udhëheqë dhe mbikëqyrë atë në kryerjen e detyrave të parashikuara dhe aktiviteteteve të punës, dhe
- ◆ Duhet të ketë shlyer të gjitha detyrimet me bazë pagat dhe kontributet e paguara për sigurim të detyrueshëm social.

#### Për personat e papunë:

- ◆ Të rinjtë deri në 34 vjet me minimum arsimit të kryer të mesëm të cilët nuk kanë përvojë pune sipas arsimit.

### KOMBINIMI ME MASA TË TJERA

Pas përfundimit të pjesëmarrjes në masë, personat e papunë kanë mundësinë të përdorin programe dhe masa të tjera nga Plani Operacional.

## Detyrimet

### Për personat e papunë:

- ◆ Rregullisht të paraqiten në vendin e punës;
- ◆ Të mbajë të dhënat e besueshme, përkatësisht informacionet e klasifikuara të punëdhënësit me të cilat ai është familjarizuar gjatë praktikës;
- ◆ Në rast pengese, të informojë punëdhënësin brenda 24 orëve për arsyen e mungesës së tij/saj dhe të sjellë një dokument arsyetimi pas mbërritjes;
- ◆ Në rast se ai i shkakton dëm punëdhënësit gjatë punës praktike, me dashje apo për shkak të pakujdesisë së rëndë, ai është detyrohet ta zhdëmtojë punëdhënësin, konform dispozitave të Ligjit të Detyrimeve;
- ◆ Të informojë punëdhënësin për pasojat e dëmshme për të cilat është i vetëdijshëm se mund të ndodhin për të, për palët e treta apo për punëdhënësin;
- ◆ Të drejtat dhe detyrimet janë përshkruar dhe rregullohen me Udhëzimet Operacionale dhe Kontratën.

### Për punëdhënësit:

- ◆ Të hartojë një plan dhe program për aftësimin e praktikantit, me detyra pune dhe aktivitete të numëruara;
- ◆ Punëdhënësi duhet të caktojë një mentor për praktikantin, i cili do të drejtojë dhe mbikëqyrë kryerjen e detyrave të parashikuara të punës dhe aktiviteteve;
- ◆ Të dërgojë raport mujor mbi rregullsinë e praktikantit në QP;
- ◆ Të lëshojë vërtetim për praktikën e kryer;
- ◆ Të sigurojë mjete mbrojtjeje në punë, nëse është e përshkruar të përdoren në vendin e punës në të cilin kryhet praktika;
- ◆ Të sigurojë konfidencialitetin e të dhënave personale dhe mbrojtjen e privatësisë së praktikantit.

## Realizimi

- ◆ Fletëparaqitje për Pjesëmarrjen e Punëdhënësve;
- ◆ Përzgjedhja e punëdhënësve;
- ◆ Shpallja e Thirrjes Publike / Njoftimi për Personat e Papunë;
- ◆ Përzgjedhja e personave të papunë;
- ◆ Realizimi i punës praktike në kohëzgjatje nga 3 muaj, dhe
- ◆ Monitorimi.



## 6. PROGRAMI I ANGAZHIMIT ME PUNË

Programi siguron përfshirjen sociale të personave që e kanë më të vështirë të punësohen në mënyrë që të fitojnë shkathtësi të caktuara dhe përfshirjen e tyre graduale në tregun e punës, me anë të implementimit të projekteve të infrastrukturës komunale dhe mbrojtjes së mjedisit në nivelin lokal.

<b>Titulli i masës</b>	<b>6. Punime publike</b>
<b>Qëllimi i masës</b>	Inkuadrimi i të papunëve me kualifikime të ulëta në projekte të infrastrukturës dhe mbrojtjes së mjedisit në nivelin lokal
<b>Grupi qëllimor</b>	Personat e papunë të regjistruar në APRMV
<b>Shtrirja e masës</b>	1050 <sup>1</sup> Të papunë të regjistruar në APRMV, nga të cilët 50 persona do të financohen nga UNDP-SDC
<b>Institucioni kompetent</b>	APRMV, MPPS, njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe Qyteti i Shkupit

### Shuma e mbështetjes financiare

**400 denarë** për person të punësuar - çdo ditë duke përfshirë tatimin mbi të ardhurat personale dhe sigurimin nga invaliditeti dhe dëmtimet trupore të shkaktuara nga dëmtimi në punë dhe sëmundja profesionale. Angazhimi me punë mund të realizohet brenda një cikli në vjet, në kohëzgjatje nga 22 ditë pune.

### Përfituesit

Të papunët nga regjistrat e APRMV me kualifikime të ulëta, me prioritet personat të cilëve do t'u zgjidhet statusi me dokumentacion personal.  
Njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe Qyteti i Shkupit

### Mënyra e aplikimit

#### Për komunitat:

Thirrje Publike, Fletëparaqitje dhe Aplikim me të cilët është arsyetuar programi i zbatimit të punëve publike

#### Për personat e papunë:

Njoftim dhe kërkim në regjistrat e të papunëve të APRMV, Deklaratë pëlqimi

### Kriteret

Programi i përzgjedhur për kryerje të punimeve publike në infrastrukturë dhe mbrojtje të mjedisit në nivelin lokal.

#### KOMBINIMI ME MASA TË TJERA

Pas kryerjes së pjesëmarrjes në masë, personat e papunë kanë mundësi të shfrytëzojnë masa dhe programe të tjera të Planit Operacional.

1. Në kuadrin e kësaj mase, do të insistohet të përfshihen 200 romë

## Detyrimet

### Për komunën:

- ◆ Lista e rregullsisë së personave të angazhuar;
- ◆ Pagimi i shpërblimit mujor personave të angazhuar;
- ◆ Prova e pagimit të bërë të shpërblimit të personave të angazhuar;
- ◆ Bashkëfinancimi i komunave në vlerë prej të paktën 20% të shpërblimit ditor.

### Për personat e papunë:

- ◆ Për kohëzgjatjen e punëve publike, kandidati detyrohet: të jetë i rregullt dhe të kryejë detyrat e punës që i janë dhënë; në rast të ndonjë pengese për t'u paraqitur në vendin e punës, brenda 24 orëve duhet ta informojë punëdhënësin për arsyen e mungesës dhe duhet të sjellë një dokument arsyetimi; të jetë i disiplinuar dhe të respektojë rendin e përcaktuar dhe të ruajë pasurinë, mjetet e punës dhe me ndërgjegje të trajtojë materialet e besuara; në rast të shkakimit të dëmit të kontraktuesi gjatë kryerjes së punimeve publike, dhe për shkak të sjelljes së pandërgjegjshme apo pakujdesisë së skajshme, ai detyrohet ta kompensojë atë.
- ◆ Rregullisht të paraqiten në vendin e punës dhe në Qendrën e Punësimit.

## Realizimi

- ◆ Aplikimi nga komuna dhe/ose Qyteti i Shkupit
- ◆ Përzgjedhja e propozim-programeve të paraqitura
- ◆ Përzgjedhja e personave të papunë
- ◆ Angazhimi me punë i personave të papunë
- ◆ Dërgimi i raportit/raporteve mbi rregullsinë e personave të angazhuar
- ◆ Pagimi i shpërblimit
- ◆ Monitorimi



## 7. EKONOMIA E KUJDESIT

Programi siguron përfshirjen e personave të papunë për të përfituar njohuri, shkathtësi dhe kompetenca për ofrimin e shërbimeve të kujdesit komunitar dhe mundësinë për angazhim me punë dhe punësim si dhënë formalë të shërbimeve në fushën e ekonomisë së kujdesit, në përputhje me nevojat e qytetarëve në nivelin lokal. Ky program do të mbështesë krijimin e vendeve të reja punës me anë të krijimit të subjekteve të reja afariste (shërbimdhënës) ose mbështetja e ndërmarrjeve ekzistuese dhe OJQ-ve.

<b>Titulli i masës</b>	<b>7.1 Puna e dobishme komunitare</b>
<b>Qëllimi i masës</b>	Rritja e punësimit përmes angazhimit me punë të personave të papunë, që synojnë ofrimin e shërbimeve sociale dhe shëndetësore në nivelin lokal
<b>Grupi qëllimor</b>	Personat e papunë të regjistruar në APRMV
<b>Shtrirja e masës</b>	
750 persona të papunë të regjistruar në APRMV, nga të cilët - 50 persona do të financohen me 100% nga buxheti i UNDP-SDC - 200 persona do të financohen me 100% nga buxhetet e komunave të Qytetit të Shkupit	
<b>Institucioni kompetent</b>	
APRMV, MPPS, MASH, UNDP-SDC, komunat dhe Qyteti i Shkupit	
<b>Shuma e mbështetjes financiare</b>	

**9.000 denarë** në muaj për person të angazhuar me punë (duke përfshirë tatimin mbi të ardhurat personale dhe sigurimin nga invaliditeti dhe dëmtimi trupor të shkakuar nga dëmtimi në punë dhe sëmundja profesionale) për 6 deri 9 muaj, për angazhim nga **20 orë pune në javë**.

**9.000 denarë** për person të papunë të përfshirë me trajnim me kohëzgjatje nga **3 muaj**. Personave të papunë që nuk kanë një certifikatë / vërtetim të duhur të njohur të aftësive / kompetencave të fituara si ofrues i shërbimit të kërkuar në sferën sociale, do t'ju kërkohet të përfshihen në trajnimin e kryer nga një ofrues i verifikuar i trajnimit. Periudha totale e përfshirjes së të papunëve me programin është 9 muaj, e cila përfshin trajnimin dhe angazhim pune.

Për 500 persona të papunë të financuar nga buxheti i APRMV, njësitë e vetëqeverisjes lokale sigurojnë bashkëfinancim me të paktën 20% të kompensimit mujor gjatë trajnimit dhe angazhimit me punë. Për numrin e mbetur të personave të papunë, kompensimi mujor gjatë trajnimit dhe angazhimit me punë do të mbulohet plotësisht (100%) nga buxhetet e komunave dhe të Qytetit të Shkupit (deri në 200 persona) dhe UNDP-SDC (deri në 50 persona).

Numri maksimal i personave të angazhuar me punë për komunë të financuar nga buxheti i APRMV është 20<sup>1</sup>.

### Përfituesit

Personat e papunë të regjistruar në APRMV  
Përfituesit e fundit të shërbimeve nga fusha sociale dhe shëndetësore  
Komunat dhe Qyteti i Shkupit

1. Mund të rritet shtrirja e të papunëve për njësi të vetëqeverisjes lokale (mbi 20 persona), nëse për personat plotësues të angazhuar me punë në një komunë të caktuar dhe në Qytetin e Shkupit, financat plotësisht janë siguruar nga buxheti i komunës, apo i Qytetit të Shkupit.

## Mënyra e aplikimit

### Për komunitat:

Thirrje Publike, Aplikim të mbështetur me memorandum(e) bashkëpunimi me OJQ, me institucione lokale dhe me partnerë të tjerë relevantë

### Për personat e papunë:

Thirrje Publike në nivelin lokal/Njoftim, kërkim në regjistrat e të papunëve me bazë profilimi dhe PIP, Fletëparaqitje dhe Deklaratë Pëlqimi

### Për përfituesit e fundit:

Thirrje Publike, Fletëparaqitje dhe Deklaratë Pëlqimi

## Kriteret

Aplikimi nga komuna, duke listuar: a) shërbimet shoqërore në përputhje me nevojat në nivelin lokal, b) shërbimet shëndetësore në përputhje me nevojat në nivelin lokal c) grupet qëllimore prioritare të personave të papunë nga kategoritë vulnerabil dhe d) grupet prioritare të përfituesve të fundit.

### KOMBINIMI ME MASA TË TJERA

Pas kryerjes së pjesëmarrjes në masë, të papunët kanë mundësi të shfrytëzojnë dhe programe dhe masa të tjera nga Plani Operacional.

## Detyrimet

### Për komunën:

- ◆ Raporte mujore mbi progresin e aktiviteteve në nivelin lokal
- ◆ Pagimi i një shpërblimi mujor për punëmarrësit
- ◆ Bashkëfinancimi nga komunat dhe Qyteti i Shkupit në vlerë prej të paktën 20% të pagesës mujore<sup>2</sup>.

### Për personat e papunë:

- ◆ Rregullisht të paraqiten në vendin e punës për të cilin janë angazhuar me punë, dhe
- ◆ Rregullisht të paraqiten në Qendrën e Punësimit ku janë regjistruar si të papunë.

## Realizimi

- ◆ Thirrja Publike drejtuar komunave
- ◆ Aplikimi nga komuna
- ◆ Përzgjedhja e propozim-programeve të parashtruara
- ◆ Shpallja e Thirrjes Publike në nivelin lokal për të papunët dhe përfituesit e fundit
- ◆ Përzgjedhja e të papunëve dhe përfituesve të fundit konform kriterëve paraprakisht të dorëzuara dhe të miratuara për përzgjedhjen e personave të papunë
- ◆ Trajnimi dhe angazhimi me punë i personave të papunë
- ◆ Dhënia e shërbimeve përfituesve të fundit
- ◆ Dërgimi i raporteve mbi progresin e aktiviteteve
- ◆ Pagimi i shpërblimit mujor
- ◆ Monitorimi

<sup>2</sup> Në kuadrin e shtrirjes së parashikuar të personave nga grupi qëllimor - përfitues të asistencës minimale të garantuar dhe grupet e tjera vulnerabil që rrezikohen nga përjashtimi social, të cilat do të financohen me mjete financiare nga Agjencia Zvicerane Për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC)/Projekti Krijimi i Mundësive të Punës për të Gjithë (UNDP), nuk do të vlejë kushti i bashkëfinancimit nga komunat dhe Qyteti i Shkupit në shumë prej të paktën 20% të pagesës mujore.

<b>Titulli i masës</b>	<b>7.2 Trajnimi dhe punësimi i personave për ofrim të shërbimeve të kujdesit komunitar për personat me aftësi të kufizuara me sëmundje kronike në komunitet</b>
<b>Qëllimi i masës</b>	Mbështetje për të papunët në përfitimin e kualifikimeve dhe shkathtësive profesionale për të ofruar shërbime të kujdesit komunitar dhe mbështetje për punësimin e tyre në fushën e ekonomisë së kujdesit.
<b>Grupi qëllimor</b>	Personat e papunë të regjistruar në APRMV: <ul style="list-style-type: none"> <li>◆ persona të papunë</li> <li>◆ të rinj të papunë deri në moshën 29 vjeç</li> <li>◆ të papunë të tjerë (prindi/kujdestari), kujdestarë të tjerë për personat me aftësi të kufizuara, persona të sëmurë për kohë të gjatë dhe pleq <sup>1</sup></li> <li>◆ të papunët me certifikatë/vërtetim për shkathtësi të përfituara/kompetenca për profesione nga fusha sociale</li> </ul>

#### Shtrirja e masës

150 persona të papunë të regjistruar në APRMV, nga të cilët

- **60** persona për ndërrimin në dhënien e kujdesit <sup>2</sup>
- **90** persona për shërbimin e kujdesit afatgjatë <sup>3</sup>

**Institucioni kompetent**  
APRMV, MPPS dhe UNDP

**Shuma e mbështetjes financiare**

**Ofruesit e trajnimit** për shkathtësi profesionale dhe kualifikime, do të marrin shpërblim prej deri **30.000 denarësh** për person në trajnim.

**Personat që do të ndjekin trajnimin** do të marrin shpërblim mujor prej **9.000 denarësh**, përfshirë sigurimin në rast aksidenti në vendin e punës dhe tatimin mbi të ardhurat personale për kohëzgjatjen e trajnimit **prej 3 muajsh**.

**30.780 denarë** në muaj për person për 10 muaj për sa kohë që zgjat dhënia e shërbimit ndaj përfituesve përfundimtarë.

Punëdhënësi mund t'i paguajë punëmarrësit një pagë edhe më të lartë, si dhe pagesë mujore për shpenzimet e rrugës.

Shumë të njëhershme deri në **3.500 denarë** për përfituesin e fundit për punëdhënësin (dhënësin e shërbimit) për të mbuluar kostot operacionale dhe të menaxhimit.

**309 denarë** në orë për përfitues të fundit për angazhimin e herëpashershëm me punë të profesionistëve (punonjës social dhe mjekësor) për ofrimin e shërbimeve të kujdesit afatgjatë për njerëzit e sëmurë, ku numri i orëve nuk mund të kalojë 20% të kohës totale të shërbimit.

1. Personi i papunë prind ose kujdestar, i cili është kujdestar joformal, mund të paraqitet si dhënësi i shërbimit vetëm i një personi nga një familje tjetër.

2. Shërbimet e **ndërrimit në dhënien e kujdesit familjar** sigurojnë strehimin afatshkurtër të anëtarëve të varur nga familja, për shkak të ndërrimit, pushimit dhe përmbushjes së nevojave personale dhe profesionale të anëtarëve të familjes që kujdesen për ata.

3. Shërbimet e **kujdesit afatgjatë për personat e sëmurë** paraqesin shërbime të ndryshme shëndetësore, shërbime shëndetësore të kombinuara me shërbime sociale, me të cilat asistohen personat me aftësi të kufizuara funksionale për shkak të gjendjeve ose aftësi të kufizuara konjitive ose mendore. Këto shërbime përfshijnë asistencë me aktivitetet e jetës së përditshme (të tilla si ngrënia, larja dhe veshja) dhe aktivitetet instrumentale të jetës së përditshme (të tilla si gatimi, pagesa e faturave) për një periudhë të gjatë kohore, shërbimi i kujdesit mjekësor - procedurat mjekësore dhe shërbimet që kërkojnë prezencën e personelit të specializuar dhe shërbimet e specializuara të tilla si fizioterapi, terapia e punës.

## Përfituesit

Personat **e papunë** të regjistruar në APRMV.

Përfituesit e fundit të **ndërrimit të dhënies së kujdesit familjar** janë anëtarët e familjes që kujdesen për të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara dhe njerëz të tjerë të sëmurë dhe të dobët që nuk janë në gjendje të kryejnë vetë aktivitetet themelore dhe instrumentale të jetës së përditshme.

Përfituesit e fundit **të shërbimeve të kujdesit afatgjatë për të sëmurët** janë personat me aftësi të kufizuara funksionale, për shkak të gjendjeve ose aftësive të kufizuara fizike, konjitive ose mendore.

Kompanitë **mikro, të vogla dhe të mesme**, ndërmarrjet sociale dhe organizatat e shoqërisë civile (jofitimprurëse) që merren me një aktivitet ekonomik në kryerjen e veprimtarisë së tyre.

## Mënyra e aplikimit

### Për punëdhënësit:

Thirrje Publike, Fletëparaqitje dhe Aplikim me të cilin është dhënë arsytimi se për cilin nga shërbimet e mëposhtme po parashtrohet Aplikimi:

- a) Shërbimet e ndërrimit në dhënien e kujdesit familjar dhe/ose
- b) Shërbimet e kujdesit afatgjatë për të sëmurët.

### Për personat e papunë:

Thirrje Publike, kërkim në regjistrat e të papunëve në APRMV, Fletëparaqitje dhe Deklaratë pëlqimi

## Kriteret

### Për punëdhënësit:

- ◆ Në ditën e aplikimit ka shlyer të gjitha detyrimet me bazë pagat dhe kontributet e paguara për sigurim të detyrueshëm social;
- ◆ Të mos ketë humbje financiare në vitin paraardhës, përveç nëse humbja është bërë për shkak të investimeve kapitale nga subjekti juridik
- ◆ Punëdhënësi duhet të ketë të paktën një punëmarrës me afat të pacaktuar, me përjashtim të organizatave të shoqërisë civile, të cilat në kohën e aplikimit nuk kanë një punëmarrës.

### Për personat e papunë:

- ◆ Përzgjedhjen e të papunëve nga regjistrat e APRMV nga grupet e numëruara qëllimore kryen punëdhënësi.

## Detyrimet

### Për punëdhënësit:

- ◆ Punëdhënësi i cili merr në punë një person të papunë në kuadrin e këtij programi, detyrohet ta punësojë personin në fjalë me orar të plotë pune dhe ta mbajë në marrëdhënie pune për të paktën 10 muaj, llogaritur nga dita e vendosjes së marrëdhënies së punës. Në qoftë se personit për të cilin ofrohet mbështetja financiare i pushon marrëdhënia e punës me cilëndo bazë, përveç në rast vdekjeje, pensionimi ose pazotësi për të vepruar, punëdhënësi detyrohet që brenda 30 ditëve, në vendin e tij të marrë në punë një të papunë tjetër të regjistruar, sepse në të kundërt detyrohet ta kthejë shumën e mjeteve financiare proporcionalisht me kohën e mbetur deri në skadimin e afatit.

### Për personat e papunë:

- ◆ Për kohëzgjatjen e trajnimit, personi i papunë detyrohet: Regularly report to the Employment Center;
- ◆ Rregullisht të paraqitet në Qendrën e Punësimit;
- ◆ Rregullisht ta vizitojë trajnimin dhe t'i kryejë detyrat e ngarkuara të punës. Në rast të pamundësisë për të marrë pjesë në trajnim, brenda 24 orëve duhet ta informojë punëdhënësin për arsyen e mungesës dhe të sjellë dokument arsyetimi. Në të kundërtën, do të përjashtohet nga trajnimi;
- ◆ Të jetë i disiplinuar dhe ta respektojë rendin e përcaktuar dhe ta respektojë pronën, mjetet e punës dhe të trajtojë me ndërgjegje materialet e besuara. Në rast të shkaktimit të dëmit gjatë trajnimit për shkak të sjelljes së pandërgjegjshme ose pakujdesisë së skajshme, detyrohet që atë t'ia kompensojë punëdhënësit.
- ◆ Kandidati që do të kryejë trajnimin dhe të cilit i është ofruar punësimi, detyrohet të lidh marrëdhënie pune tek punëdhënësi. Në qoftë se refuzon të lidh marrëdhënie pune, detyrohet t'i kthejë mjetet financiare në shumë të përgjithshme deri 30.000 denarë, aq sa kishte qenë kostoja e trajnimit të tij, përveç në rast të punësimit tek një punëdhënës tjetër.

## Realizimi

- ◆ Aplikimi nga punëdhënësi
- ◆ Përzgjedhja e aplikimeve të paraqitura
- ◆ Lajmërimi për personat e papunë
- ◆ Paraqitja dhe përzgjedhja e të papunëve
- ◆ Përzgjedhja e ofruesve të trajnimit
- ◆ Trajnimi i personave të papunë
- ◆ Punësimi
- ◆ Monitorimi
- ◆ Dërgimi i raportit/raporteve mbi rregullsinë e personave në trajnim dhe në vendin e punës
- ◆ Pagimi i pagesës mujore (subvencion)
- ◆ Monitorimi

<b>Titulli i masës</b>	<b>7.3 Mbështetja e sipërmarrësisë dhe formimi i subjekteve juridike dhe shërbimdhënësve komunitarë</b>
<b>Qëllimi i masës</b>	Mbështetja e krijimit të vendeve të reja të punës me anë të hapjes së subjekteve të reja afariste (shërbimdhënës të ardhshëm), të cilët do të ofrojnë shërbime kujdesi në komunitet.
<b>Grupi qëllimor</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>◆ persona të papunë të regjistruar në APRMV</li> <li>◆ të rinj të papunë deri në moshën 29 vjeç</li> <li>◆ të papunë të tjerë (prind/kujdestar), kujdestarë të tjerë për personat me aftësi të kufizuar, persona të sëmurë për kohë të gjatë dhe pleq</li> <li>◆ persona të papunë me certifikatë/vërtetim të pranuar për shkathtësi/kompetenca të përfituara për profesionet e fushës sociale</li> </ul>
<b>Shtrirja e masës</b>	<b>70 persona</b> të papunë të regjistruar në APRMV <sup>1</sup>
<b>Institucioni kompetent</b>	APRMV, MPPS, UNDP, njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe Qyteti i Shkupit

### Shuma e mbështetjes financiare

Deri **307.500 denarë** apo deri **615.000 denarë** (në qoftë se themelohet një subjekt juridik me dy bashkëthemelues).

Ofruesit e trajnimit për kualifikime profesionale, do të marrin pagesë deri **30.000 denarë** për person në trajnim.

**Personat që do të ndjekin trajnim** do të marrin shpërblim mujor prej **9.000 denarësh**, përfshirë dhe sigurimin në rast aksidenti në vendin e punës dhe tatim mbi të ardhurat personale për kohëzgjatje prej **3 muajsh**.

**29.180 denarë** për muaj, si subvencionim i pagës së punëmarrësit për një periudhë deri ose 10 muaj për punësimin e personave nga grupet qëllimore. Punëdhënësi mund t'i paguajë punëmarrësit një pagë edhe më të lartë.

### Përfituesit

Personat e papunë të regjistruar në APRMV  
Të rinj të papunë deri në moshën 29 vjeç

### Mënyra e aplikimit

#### **Për personat e papunë - sipërmarrës të ardhshëm:**

Thirrje Publike / Njoftim, Fletëparaqitje dhe Pyetësor për vlerësimin e afiniteteve sipërmarrëse.

#### **Për personat e papunë të paraqitur si shërbimdhënës:**

Thirrje Publike, kërkim në regjistrat e të papunëve në APRMV, Fletëparaqitje dhe Deklaratë pëlqimi

<sup>1</sup> 60 të papunë do të dekorohen me një certifikatë të pranuar për njohuri të grumbulluara për dhënie të shërbimeve të kujdesit në komunitet. 10 sipërmarrës do të mbështeten për themelimin e një subjekti afarist, të cilët do të mund të punësojnë të paktën 5 shërbimdhënës të trajnuar.



## Kriteret

Pjesëmarrja në masën dhe përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet me bazë konkurrueshmërinë, në përputhje me kriteret e mëposhtme:

- ◆ Pyetëtori i plotësuar me sukses;
- ◆ Trajnimi i kryer mbi "Sipërmarrësinë dhe zhvillimin e shkathtësive sipërmarrëse";
- ◆ Ideja e biznesit dhe plani i biznesit të hartuar me mbështetje këshillëdhënëse;
- ◆ Plan i Biznesit i vlerësuar pozitivisht nga komisioni ekspert;

## BASHKIMI I PËRFITUESVE

Në rast se dy persona janë të interesuar të fillojnë një ndërmarrje së bashku (si bashkëthemelues), të dy personat e papunë së bashku duhet të kalojnë të gjitha hapat e zbatimit (deklarata e pjesëmarrjes, pyetëtori, hartimi i një ideje të përbashkët biznesi dhe i një plani të përbashkët të biznesit, etj.).

Subjekti juridik i themeluar nga dy bashkëthemelues, në Regjistrin e Shoqërive Tregtare regjistrohet si **SHPK - Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me dy persona**, ku secili nga bashkëthemeluesit ka aksione të barabarta (50%) në shoqërinë.

Shuma e grantit bazë për themeluesit e kompanisë mund të arrijë deri në 615.000 denarë.

## Detyrimet

### Për personat e papunë themelues të subjektit juridik:

Në qoftë se personi juridik përfundon veprimtarinë e tij brenda 12 muajve nga regjistrimi i subjektit juridik ose marrëdhënia e punës e përfituesit të grantit pushon për ndonjë arsye (përveç në rast të pazotësisë për të vepruar ose vdekjes) brenda 12 muajve nga krijimi i marrëdhënies së punës, themeluesi/përfituesi i grantit detyrohet të kthejë 50% të grantit.

Themeluesi/përfituesi i grantit që do t'i japë fund kryerjes së veprimtarisë, nuk mund të kthehet në regjistrat e të papunëve për 3 vjet nga dita e lidhjes së marrëdhënies së punës.

Subjekti juridik i cili punëson një person plotësues (shërbimdhënës) në kuadrin e kësaj mase, detyrohet ta punësojë personin me orar të plotë pune dhe ta mbajë në marrëdhënie pune për të paktën 12 muaj.

Në qoftë se gjatë periudhës së detyrimit të parashikuar, pushon marrëdhënia e punës së punëmarrësve plotësues, përveç nëse arsyet e pushimit të marrëdhënies së punës janë vdekja ose pazotësia për të vepruar, punëdhënësi detyrohet të punësojë një person tjetër të papunë të regjistruar në APRMV, sepse në të kundërt, duhet të kthejë mjetet financiare në një shumë proporcionale me detyrimin e parealizuar për numrin e ulur të punëmarrësve.

Subjekti juridik / përfituesi që mbështetet në përputhje me këtë masë detyrohet të përmbushë obligimet ligjore për pagimin e pagës dhe kontributeve për të gjithë 12 muajt nga dita e lidhjes së marrëdhënies së punës, sepse në të kundërt detyrohet të kthejë fondet e paguara / të shfrytëzuara në plotësi.

Të drejtat dhe detyrimet janë përshkruar dhe rregullohen me Udhëzimet Operacionale dhe Kontratën

### Për personat e papunë - dhënës të shërbimeve të kujdesit:

→ Për kohëzgjatjen e trajnimit, personi i papunë detyrohet:

- ◆ Rregullisht të paraqitet në Qendrën e Punësimit;
- ◆ Rregullisht ta ndjekë trajnimit dhe t'i kryejë detyrat e ngarkuara të punës. Në rast të pamundësisë për të marrë pjesë në trajnim, brenda 24 orëve ta informojë punëdhënësin për arsyen e mungesës dhe të sjellë një dokument arsyetimi. Në të kundërtën, do të përjashtohet nga trajnimit;

- ◆ Të jetë i disiplinuar dhe ta respektojë rendin e përcaktuar dhe ta respektojë pronën, mjetet e punës dhe të trajtojë me ndërgjegje materialet e besuara. Në rast të shkaktimit të dëmit gjatë trajnimit për shkak të sjelljes së pandërgjegjshme ose pakujdesit të skajshëm, detyrohet që t'ia kompensojë atë punëdhënësit;
- ◆ Personi i papunë që do të kryejë trajnimin dhe të cilit i ofrohet një punësim, detyrohet ta lidh atë marrëdhënie pune tek punëdhënësi. Në qoftë se refuzon të lidh marrëdhënie pune, detyrohet t'i kthejë fondet në shumë deri 30.000 denarë, aq sa ka qenë kostoja e trajnimit, përveç në rast punësimi tek një punëdhënësi tjetër.

### Realizimi

- ◆ Thirrje Publike / Njoftim për personat e papunë
- ◆ Fletëparaqitja dhe plotësimi i Pyetësorit
- ◆ Trajnimi mbi Sipërmarrësinë dhe zhvillimin e shkathtësive afariste
- ◆ Hartimi i një Plani të Biznesit me mbështetje këshillëdhënëse me anë të sistemit të vauçerit të këshillimit të AMSRMV
- ◆ Përzgjedhja e planeve të biznesit më të suksesshme, duke marrë parasysh kriteret e përfaqësimit rajonal
- ◆ Përzgjedhja e ofruesve të trajnimit
- ◆ Trajnimi i të papunëve për shkathtësi profesionale dhe kualifikime për dhënësit e shërbimeve të kujdesit
- ◆ Dërgimi i raportit/raporteve mbi rregullsinë e personave në trajnim dhe në vendin e punës
- ◆ Regjistrimi i kompanisë dhe punësimi
- ◆ Prokurimi i pajisjes së re të punës dhe materialet e themelimit dhe nisjes së biznesit. Shuma e grantit është deri në maksimumin prej 307.500 denarësh apo deri 615.000 denarë në qoftë se themelohet një subjekt juridik me dy bashkëthemelues. Një pjesë e këtyre fondeve mund të shfrytëzohet për subvencionimin e pagave të themeluesit të kompanisë, në përputhje me buxhetin e planifikuar në Planin e Biznesit të përfituesit
- ◆ Punësimi i personave të trajnuar - dhënës të shërbimeve të kujdesit
- ◆ Pagimi i subvencionit mujor për punëmarrësit në subjektin juridik dhe i shpenzimeve operacionale të kompanisë
- ◆ Mbështetja këshillëdhënëse dhe mentoriale për sipërmarrësit e subjekteve të sapokrijuara afariste dhe për punëmarrësit - dhënës të shërbimeve të kujdesit
- ◆ Monitorimi



## 8. PAGIMI I SHITESËS RINORE

Titulli i masës	Pagimi i shtesës rinore
<b>Qëllimi i masës</b>	
Inkurajimi i punësimit të të rinjve deri 23 vjeç në veprimtaritë e prodhimtarisë pas përfundimit të arsimit të mesëm, që do të kontribuonte për përmirësimin e standardit jetësor të tyre me anë të punës dhe përmbushjes së nevojave të punëdhënësve me krah përkatësisht të kualifikuar pune.	
<b>Grupi qëllimor</b>	Të rinj deri 23 vjeç, që do të lidh marrëdhënie pune ose janë punësuar në veprimtaritë nga fusha e prodhimtarisë
<b>Shtrirja e masës</b>	2.500 të rinj deri në moshën 23 vjeç
<b>Institucioni kompetent</b>	APRMV
<b>Shuma e mbështetjes financiare</b>	
<b>3.000 denarë</b> në muaj për punëmarrës.	
<b>Përfituesit</b>	

Shtesën rinore mund ta përdorë një person i ri deri 23 vjeç, i cili përmbush kushtet e mëposhtme:

- ◆ është përfshirë me sigurim të detyrueshëm social me bazë punësimi tek një punëdhënës ose vetëpunësimi me veprimtari kryesisht prodhimtare;
- ◆ është punësuar në një agjenci private punësimi dhe është dorëzuar për punë tek një punëdhënës me veprimtari kryesisht prodhimtare, ose
- ◆ është përfshirë me sigurim të detyrueshëm social si bujk individual.

### Mënyra e aplikimit

#### **Për përdoruesit:**

Kërkesa e paraqitur në Qendrën përgjegjëse të Punësimit, sipas vendbanimit të të riut, në qoftë se i riu përmbush kushtet e përcaktuara me Ligjin e Shtesës Rinore.

## II SHËRBIMET E PUNËSIMIT

Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë së Veriut (APRMV) me qendrat e saj të punësimit (QP) zhvillon dhe zbaton shërbime për rritjen e konkurrueshmërisë së fuqisë punëtore dhe për të përmbushur nevojat e tregut të punës, duke aplikuar një qasje individuale për punën e orientuar drejt nevojat e të papunëve dhe punëdhënësve.

APRMV gjithashtu realizon aktivitete për promovimin dhe njohjen e punëdhënësve me masat dhe shërbimet që kanë në dispozicion. Në bashkëpunim me punëdhënësit, qendrat e punësimit ndërmjetësojnë në punësimin e krahut të punës në përputhje me kërkesat e punëdhënësit, përfshirjen e tyre në programe dhe masa të caktuara aktive të punësimit, raportimin e vazhdueshëm dhe informimin mbi të gjitha aktivitetet aktuale dhe programet dhe masat aktive të punësimit, etj. .

Informimi dhe ftesa e personave të papunë për të marrë pjesë në shërbimet e punësimit bëhet me njoftime me shkrim dhe me gojë, kontakte telefonike, mesazhe SMS, informacione në portalin në internet të APRMV, etj. Pjesëmarrësit do të përfshihen me shërbimin në Qendrën e Punësimit, në bazë të nevojave dhe interesave të shprehura, këshillimeve dhe rekomandimeve të Planit Individual të Punësimit (PIP) të personit në fjalë, etj.

Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë së Veriut ofron shërbimet e mëposhtme:

### **1.ASISTENCË NË KËRKIMIN E PUNËS**

Shërbimi përfshin profilimin dhe përgatitjen e një Plani Individual të Punësimit, këshillimin për punësim, sigurimin e informacioneve mbi gjendjet dhe kërkesat në tregun e punës, gjegjësisht, vendet e lira të punës, si dhe informacione mbi programet dhe masat e punësimit, si dhe shërbimet që ofron APRMV. Për më tepër, qendrat e punësimit ofrojnë asistencë për personat e papunë në hartimin e CV-së dhe letrës së motivimit, forcimin e shkathtësive të prezantimit të suksesshëm para punëdhënësve në intervistën e punës, përmes informimit dhe këshillimit, dhe ofrojnë edukim në përdorimin e shërbimeve onlajn të APRMV përmes portalit elektronik të APRMV, si dhe organizimin e takimeve informuese për të rinjtë dhe personat e tjerë të papunë, etj.

### **2.TRAJNIMET MOTIVUESE**

Trajnimet motivuese do të organizohen në formën e trajnimeve njëditore në qendrat e punësimit, e të cilat synojnë informimin e shtuar, si dhe motivimin për përfshirje në programet dhe masat aktive të punësimit. Motivimi i personave të papunë që në mënyrë aktive të kërkojnë punë do të realizohet edhe me qasje individuale, në qoftë se të papunët shprehin nevojë për mbështetje dhe këshillime plotësuese.

### **3.TRAJNIMET “PËRGATITJA PËR PUNËSIM DHE PËR PUNË”**

Shërbimi përfshin zbatimin e trajnimeve për të rinj të papunë deri 29 vjeç, me bazë programin “Përgatitja për punësim dhe për punë”, i cili përfshin modulet e mëposhtme: moduli hyrës, zhvillimi personal, shkathtësitë e kërkimit të punës, shkathtësitë e komunikimit, sjellja përkatëse në vendin e punës, puna ekipore dhe lidhshipi, siguria, të drejtat dhe detyrimet në punë dhe shkathtësitë financiare.

Ato do të realizohen me anë të punëtorive, duke aplikuar metoda që të rinjtë i gjejnë të afërta dhe efektive për edukimin dhe përvetësimin e shkathtësive të reja në mënyrë bashkëvepruese.

#### **4.ORIENTIMI PROFESIONAL DHE KËSHILLIMI PËR KARRIERË**

Shërbimi përfshin aktivitete të ndryshme informimi, këshillimi grupor dhe individual për karrierë, etj. Të papunët mund të përfshihen në disa aktivitete në kuadrin e shërbimit, konform interesave dhe nevojave të tyre. Orientimi profesional dhe këshillimi për karrierë u mundësojnë të papunëve të zhvillojnë shkathtësi në kërkimin e punës dhe planifikimin dhe menaxhimin e zhvillimit të karrierës së tyre, duke ndihmuar në përzgjedhjen e profesionit, trajnimit ose punësimit, si dhe mbështetje shtesë në vlerësimin e potencialeve vetjake të punësimit dhe përafrimin e tyre me nevoja e tregut të punës.

#### **5.AKTIVIZIMI I ROMËVE TË PAPUNË DHE PERSONAVE TË TJERË TË RREZIKUAR NGA PËRJASHTIMI SOCIAL**

Shërbimi do të drejtohet ndaj gjithë romët e papunë dhe gjithë personat e tjerë të rrezikuar nga përjashtimi social. Të papunët do të kenë akses te ekipi i mentorëve, të cilët do të angazhohen në komunitetet lokale. Roli i tyre do të jetë të motivojnë dhe rregullisht t'i informojnë kandidatët për mundësitë e punësimit apo për përmirësimin e kapaciteteve të tyre profesionale. Me qasje individuale për identifikimin e njohurive, kualifikimet dhe shkathtësitë me të cilat disponojnë personat, do të bëhet referimi në programet përkatëse të Planit Operacional për programe dhe masa aktive punësimi dhe shërbime në tregun e punës.

Për më tepër, përfshirja në tregun e punës së romëve dhe personave të tjerë të rrezikuar nga përjashtimi social do të mbështetet me anë të programeve që kanë si bazë përvojat ndërkombëtare (programi Acceder). Shërbimi do të ofrohet në kuadër të projektit të UNDP, MPPS dhe APRMV - Krijimi i mundësive të punës për të gjithë, mbështetur nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

Modeli do të realizohet me krijimin e qendrave pilot për mbështetjen e punësimit të romëve dhe personave të tjerë të rrezikuar nga përjashtimi social, në partneritet me organizata të përzgjedhura të shoqërisë civile në komuna pilot me prani të konsiderueshme romë dhe me një mjedis biznesi të zhvilluar mirë. Qëllimi është të mundësohet punësimi dhe përfshirja sociale e të papunëve me anë të planeve individuale të punësimit dhe bashkëpunimit të ngushtë me sektorin lokal të biznesit, si dhe kërkesës aktuale për krah pune.

Plani Individual i Punësimit konsiston në gjashtë faza kryesore:

- Vlerësimi i parë i kapacitetit për punësim
- Hartimi i një Plani Individual të Punësimit duke u mbështetur në metodologjinë Acceder
- Aftësimi i kandidatëve për identifikim dhe aplikim të mëvetësishëm për pozita të hapura pune
- Mbështetja në identifikimin dhe qasjen në trajnim për të fituar shkathtësi të buta dhe profesionale, aftësi dhe zakone
- Punësimi i kandidatëve me anë të ndërmjetësimit ose me anë të aktivitetit të tyre të pavarur dhe vëzhgimi i punësimit

#### **6.NDËRMJETËSIMI NË PUNËSIM**

Ndërmjetësimi bëhet pas pranimit të Kërkesës për ndërmjetësim në punësim nga punëdhënësi. Ky shërbim përfshin këshillim dhe asistencë për punëdhënësit, duke kërkuar kandidatë për vende të lira pune në regjistrat e të papunëve të APRMV, duke kryer përzgjedhje paraardhëse, duke referuar të papunët tek punëdhënësi për intervistë pune, etj.

## **7. SHËRBIMET PËR PUNËDHËNËSIT**

Shërbimet për punëdhënësit përfshijnë: informim, këshillim dhe ofrim të mundësive të shfrytëzimit të shërbimeve dhe programeve dhe masave aktive për punësim dhe mundësi të tjera për punësimin e të papunëve që janë vënë në dispozicion përmes APRMV, shfrytëzimi i shërbimeve elektronike të APRMV, informacione dhe shërbime nga fusha e legjislacionit të punës, pjesëmarrja në evenimente të përbashkëta, siç janë forumet për punëdhënësit, etj.

## **8.SONDAZHI PËR NEVOJAT E SHKATHTËSIVE NË TREGUN E PUNËS**

Me anë të anketimit të punëdhënësve nga sektori privat, do të sigurohen shërbime për nevojat e tyre për punësime të reja në periudhë nga 6 deri 12 muaj. Përmes një pyetësoi të përgatitur më herët, do të përcaktohen nevojat për profesione të punësimeve të reja të planifikuara dhe shkathtësitë që duhet të posedojnë personat e papunë për punësimet e reja të planifikuara tek punëdhënësit. Për realizimin e këtij sondazhi, 20 persona të papunë do të punësohen nga APRMV për 1 muaj me pagesë prej 9.000 denarësh.

## **9.KDHM - KËSHILLIMI DHE MOTIVIMI PËR PËRFITUESIT E ASISTENCËS MINIMALE TË GARANTUAR**

Përfituesit e asistencës minimale të garantuar do të gëzojnë të drejtën e shërbimit të Këshillimit dhe Motivimit (KDHM), i cili konsiston në mbështetje intensive psikosociale të përfituesve para se të përfshihen me një masë aktive punësimi, si dhe mbështetje mentoriale, e cila është më intensive në periudhën kur përfituesi përfshihet në trajnim ose masë tjetër aktive të punësimin, dhe me intensitet të reduktuar, pasi përfituesi të punësohet dhe të integrohet në tregun e punës. Shërbimi KDHM është komplementare kundrejt programeve dhe shërbimeve të punësimin dhe mundëson këshillim, mbështetje dhe motivim, mirëpo edhe vëzhgimin e përfituesit të asistencës minimale të garantuar nëpër procesin e aktivizimit.


## GARANCIA PËR TË RINJ

Me Garancinë për Rinj (GR), të rinjve (15-29 vjeç) në një periudhë katër muajsh pas regjistrimit në regjistrat e të papunëve, u ofrohet punësim, arsimim dhe trajnim i vazhdueshëm, gjegjësisht, përfshirje në një nga programet dhe masat aktive të punësimit.

Në vitin 2021, zbatimi i Garancisë për të Rinj do të vazhdojë të realizohet në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me theks të veçantë te të rinjtë NEET (personat që janë të papunë, e që nuk janë përfshirë në arsim ose trajnim). Shtrirja e planifikuar i pjesëmarrësve në Garancinë për të Rinj në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut është rreth 10.000 të rinj. Programi do të konsiderohet i suksesshëm nëse të paktën 30% të personave të përfshirë me GR dalin nga ajo me sukses brenda 4 muajve, pra do të punësohen, do të ri-përfshihen në procesin arsimor, ose do të përfshihen me programe aktive dhe masa punësimi.

Për këtë qëllim nevojitet veprim i koordinuar dhe i përbashkët i disa institucioneve qeveritare, kryesisht i MPPS, APRMV dhe MASH, partnerët socialë dhe organizatat e shoqërisë civile. Organizatat e shoqërisë civile do të përfshihen në aktivitetet në terren, gjegjësisht gjetja e të rinjve NEET, prezantimi i tyre me Garancinë e të Rinjve, mundësitë e ofruara nga Garancia për të Rinj dhe motivimi i tyre për t'u bashkuar me Garancinë për të Rinj.

Të rinjtë e papunë të cilët do të përfshihen me GR do të sigurohen me shërbime të përshtatshme punësimi, të cilat do të mundësojnë aktivizimin dhe motivimin e tyre për përfshirje në tregun e punës përmes të së ashtuquajturës "mundësi e dytë", pra ripërfshirja në procesin arsimor përmes programeve të shkurtra të trajnimit brenda shkollave të mesme profesionale, si dhe masave aktive të punësimit, gjegjësisht ndërmjetësimit me punëdhënësit.



## AKTIVIZIMI I PËRFITUESVE TË AMG

Sistemi i reformuar i mbrojtjes sociale parashikon aktivizimin e zgjeruar të përfituesve të asistencës minimale të garantuar (AMG) në një mënyrë të tillë që anëtarët e familjes me zotësi për të vepruar do të përfshihen në programet dhe masat aktive të punësimit për të përmirësuar kapacitetin e tyre të punësimit dhe punësimin e tyre.

Kjo nënkupton pjesëmarrje të detyrueshme dhe të vazhdueshme në trajnime, si dhe pranimin e ofertës së punës.


Në këtë kuptim, veç tjerash, përfituesve do t'u sigurohet mbështetja për përmirësimin e shkathtësive të tyre, që do t'i bëjë më konkurrent në tregun e punës.

Realizimi i aktivizimit të përdoruesve të AMG kërkon bashkëpunim ndërmjet personit që është drejtues i rastit dhe profesionistëve të tjerë nga qendrat e punës sociale (QPS) si dhe personave përgjegjës në qendrat e punësimit të ngarkuar për zbatimin e shërbimeve të punësimit (trajnime motivuese, udhëzime në karrierë dhe orientim profesional, etj.).

Me anë të një qasjeje të integruar të punës, për 1.200 përfitues të AMG do të hartohen plane individuale të aktivizimit të cilat do t'ua bëjnë të mundur atyre përfshirjen në programet, masat dhe shërbimet e punësimit të ofruara nga Plani Operacional për 2021.

Sistemi i ri i aktivizimit do të promovojë një qasje të re në tregun e punës, e cila do të lidhet me mbështetjen dhe zhvillimin e shkathtësive dhe potencialeve individuale të përfituesve të programeve dhe masave.

Sistemi i aktivizimit të përfituesve të AMG do të ofrojë mbështetje intensive psikosociale dhe mentoriale (Shih shërbimin nën numrin 9 - KDHM - Këshillim dhe Motivim për përdoruesit e PMP) dhe trajnime, nga 3 në 12 muaj për të kapërcyer pengesat që pamundësojnë pjesëmarrjen e tyre në tregun e punës.





# REHABILITIMI PROFESIONAL DHE PËRFSHIRJA NË TREGUN E PUNËS E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR

Rehabilitimi profesional si një sistem shërbimesh do t'u sigurojë individëve me aftësi të kufizuar mbështetje të individualizuar, në mënyrë që t'i integrojë plotësisht ata në tregun e hapur të punës. Do të zbatohet në kuadrin e Projektit të UNDP, MPPS dhe APRMV - Krijimi i mundësive të punës për të gjithë, të mbështetur nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

Rehabilitimi profesional si model do të vendoset dhe zbatohet në qendrat REHA - qendrat e rehabilitimit profesional dhe mbështetjes në punësimin e personave me aftësi të kufizuar, në Shkup dhe Strumicë.

Në kuadrin e këtij modeli, shërbimet do të ofrohen në nivelin lokal, në komunitetin e klientit. Modeli mundëson zbatimin e një qasjeje të orientuar drejt klientit që përqendrohet në potencialet e tij individuale dhe zbatohet brenda një rrjeti lokal të shërbimdhënësve - qendrat REHA, qendrat rajonale të APRMV, organizatat e shoqërisë civile, qendrat e trajnimit, institucionet arsimore, punëdhënësit, etj.

Në zbatimin e masave dhe aktiviteteve të rehabilitimit profesional, do të aplikohen aktivitetet e mëposhtme, të prezantuara në skemën e mëposhtme:



### Qasja komunikuese strategjike në promovimin e programeve dhe masave aktive

Për të siguruar informimin e mëkohshëm për të gjitha palët e përfshira me programet dhe masat aktive në 2021, si dhe për të synuar sa më shumë përfitues të mundshëm, aktivitetet promovuese për këtë vit do të përcaktohen në përputhje me 3 kriteret kryesore:

#### 1. me saktësi 2. me bashkëveprim 3. në kohë

Qasja komunikuese strategjike do të përqendrohet në grupet qëllimore kryesore, me të cilat do të vihet theksi mbi përfitimet dhe kriteret e përgjithshme të secilit program/masë.

A) të rinj të papunë deri 29 vjeç,

- ◆ Të paaktivizuar në tregun e punës, por me dëshirë për rikualifikim dhe kualifikim plotësues
- ◆ Me ide biznesi inovative

B) persona me aftësi të kufizuar

C) persona të papunë nga zonat rurale, kategoritë vulnerabil dhe grupet me vështirësi në punësim

Ç) përfitues të asistencës sociale

DH) punëdhënës, me theks të veçantë mbi të rinjtë, gratë, zonat rurale, bizneset inovative

#### **Fushata promovuese “Shans për të gjithë”**

Në varësi nga dinamika dhe disponueshmëria, si dhe përmbushja e shtrirjes së programeve dhe masave të punësimin, aktivitetet promovuese në kuadrin e fushatës tanimë të vendosur “Shans për të gjithë” do të realizohen me faza. Për rikujtim, bëhet fjalë për një fushatë të integruar promovuese e cila do të prodhojë një seri produktesh që do të përcjellin drejtpërdrejt “historinë e suksesit” të përfituesve të vërtetë të masave të PO. Në fund të vitit do të realizohet një fushatë afatshkurtër për promovimin e rezultateve të suksesshme të publikuara përgjithësisht në mediat sociale.

#### **Fushata promovuese për okupacione profesionale dhe arsimim profesional “Gjendu me profesionalen!”**

Gjatë vitit 2021, fushata e përbashkët për promovimin e okupacioneve profesionale dhe arsimit profesional të realizuar nga disa partnerë që zbatojnë aktivitete të përqendruara në të njëjtën temë do të vazhdojë. Fushata promovuese do të zgjasë deri në vitin 2021, dhe trupi koordinues i përbërë nga përfaqësues të subjekteve të ndryshme do të vazhdojë të punojë drejt krijimit dhe zbatimit të kanaleve dhe produkteve shtesë të komunikimit për shënjestrim më të suksesshëm të nxënësve, por edhe të subjekteve të biznesit që duhet të sigurojnë parakushtet e duhura për tërheqjen e stafit të kualifikuar profesional.

#### **Mbështetja plotësuese e komunikimit**

PO 2021 do të mbështetet vazhdimisht edhe përmes kanaleve të tjera inovative dhe aktive të komunikimit që tregojnë rezultate të mira në promovimin dhe informimin mbi temat që lidhen me PO.

**Info-klubet (gjithsej 5)**, me moton tanimë të njohur “**Nga informimi në karrierë**”, do të realizojnë mbështetje të vazhdueshme të komunikimit, me fokus në komunikimin digjital interaktiv të sapo prezantuar me studentët. Info-klubi do të vazhdojë të jetë një “pikë fokusi” për paraqitjen e mundësive të punës praktike, punësimin në sektorin e biznesit, mbajtjen e takimeve informuese të drejtpërdrejta ndërmjet përfaqësuesve të komunitetit të biznesit dhe studentëve. Do të merren parasysh mediat sociale, vendosja e banderolave interaktive në internet në info-portalet përkatëse për të rinjtë, “Panairët e Suksesit” etj.

- ◆ **Partneritete strategjike me veprues relevantë**, para së gjithash, me donatorë, media, dhoma ekonomike rajonale dhe asociacione biznesi, organizata dhe shoqata të shoqërisë civile, mirëpo edhe me partnerë të tjerë relevantë. Duke u përqendruar në tema të hapura dhe aktuale, takimet e drejtpërdrejta me palët e interesit do të inkurajojnë interesin, vëmendjen, por edhe diskutimin e frytshëm dhe konstruktiv, veçanërisht duke synuar veprues të ndryshëm aktivë të cilët do të prisnin një qasje të tillë. Informimi dhe përfshirja e ndërmarrjeve në proces do të realizohet përmes takimeve në nivelin kombëtar të dhomave dhe shoqatave, rajonalisht, në nivelin e dhomave rajonale dhe të synuara në nivelin e kompanive me potencial të konsiderueshëm punësimi. Me mbështetjen e projekteve partnere, janë planifikuar aktivitete për të rritur bashkëpunimin e APRMV, dhomave dhe shoqatave në mënyrë që të përfshijnë sektorin privat dhe të përmirësojnë mekanizmat e tregut të punës.

### **Parametrat e përgjithshëm të komunikimit**

**Kuadri kohor:** në vazhdim, gjatë tërë vitit, paralelisht për të gjitha temat kryesore

**Kanalet:** mediat sociale, media onlajn dhe platformat digjitale përkatëse të informacionit, mediat / platformat e specializuara, ngjarje dhe iniciativa të përqendruara dhe tematike

**Qasja:** paraqitja personale dhe e përqendruar, përmbajtja e konkretizuar, zgjidhjet e thjeshta dhe të lehta për t'u lexuar vizuale dhe audio, këshilla dhe udhëzime praktike / pragmatike / të arritshme, teknikisht të pangarkuara nga terminologjia administrative

**Palët e përfshira:** Ministritë dhe institucionet e tjera përkatëse, organizatat relevante ndërkombëtare, përfituesit e përfshirë përmes historive të suksesit, profile të shquara duke shpërndarë mesazhe motivuese



## KUADRI FINANCIAR

**TABELA 1. Buxheti total dhe shtrirja e personave me programe dhe masa punësimi**

I. PROGRAMET DHE MASAT E PUNËSIMIT	SHTRIRJA E PERSONAVE	BURIMI I MJETEVE FINANCIARE	SHUMA
<b>1. MBËSHTETJA E VETËPUNËSIMIT (SIPËRMARRËSISË)</b>	<b>1.762</b>		<b>591.913.222</b>
1. Mbështetja e vetëpunësimit (sipërmarrësisë)	1762	Buxheti i MPPS kundrejt APRMV	538.000.000
		Buxheti i AMSRMV	15.000.000
		Buxheti i UNDP (fondet e perealizuara nga PO 2020)	13.955.547
		Buxheti i APRMV - Nënlogaria e programeve dhe masave aktive të punësimit - Shlyerja e detyrimeve të mbetura nga PO 2020 në vitin 2021	3.436.500
		Zyra e Kombeve të Bashkuara për Mbështetjen e Projekteve (UNOPS) - Shlyerja e detyrimeve të mbetura nga PO 2020 në vitin 2021	15.990.000
		<b>Shoqata REDI Shkup</b>	5.531.175
<b>2. MBËSHTETJA KRIJIMIT TË VENDEVE TË REJA TË PUNËS</b>	<b>1.302</b>		<b>513.296.580</b>
2.1 Subvencionimi i pagave	866	Buxheti i APRMV - Nënlogaria e programeve dhe masave aktive të punësimit	179.371.600
		Buxheti i APRMV - IPA II - granti i katërt i drejtpërdrejtë	10.452.480
2.2 Punësimi dhe rritja e subjekteve juridike	226	Buxheti i APRMV - Nënlogaria e programeve dhe masave aktive të punësimit	33.972.500
2.3 Mbështetja e punësimit të personave me aftësi të kufizuar	210	Buxheti i APRMV - Nënlogaria e Fondit të Posaçëm për Personat me Invaliditet	289.500.000
<b>3. TRAJNIMET</b>	<b>882</b>		<b>54.362.300</b>
3.1 Trajnimi në vendin e punës për një punëdhënës të njohur	152	Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) / Projekti Arsimimi për Punësim në Maqedoninë e Veriut (E4E@mk)	3.024.000
		Buxheti i APRMV - IPA II - granti i katërt i drejtpërdrejtë granti i drejtpërdrejtë	3.360.000
		Buxheti i APRMV - Nënlogaria e programeve dhe masave aktive të punësimit - Shlyerja e detyrimeve të mbetura nga PO 2020 në vitin 2021	1.220.000
3.2 (a) Trajnimi për kualifikime profesionale me kërkesë të punëdhënësve	100	APRMV - Nënlogaria e programeve dhe masave aktive kundrejt UNDP	3.292.650
		Buxheti i UNDP (fondet e perealizuara nga PO 2020)	3.637.350
3.2 (b) Trajnime profesionale me kërkesë të punëdhënësve	80	Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) / Projekti Krijimi i mundësive të punës për të gjithë (UNDP)	5.702.400
3.2 (c) Trajnime onlajn për shkathtësi me kërkesë të punëdhënësve	100	Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) / Projekti Krijimi i mundësive të punës për të gjithë (UNDP)	3.240.000

3.3 Trajnime mbi okupacionet e kërkuara	400	Buxheti i APRMV - Nënlogaria e programeve dhe masave aktive të punësimit	10.200.000
		Buxheti i APRMV - IPA II - granti i katërt i drejtpërdrejtë	10.200.000
		Zyra e Kombeve të Bashkuara për Mbështetjen e Projekteve (UNOPS) - Shlyerja e detyrimeve të mbetura nga PO 2020 në vitin 2021	8.550.000
3.4 Trajnimi i shoferëve për kategorinë C dhe D	50	Buxheti i APRMV - Nënlogaria e programeve dhe masave aktive të punësimit	1.850.000
		Buxheti i APRMV - Nënlogaria e programeve dhe masave aktive të punësimit - Shlyerja e detyrimeve të mbetura nga PO 2020 në vitin 2021	85.900
<b>4. TRAJNIMET E ZHVILLIMIT TË SHKATHTËSIVE DIGJITALE</b>	<b>400</b>		<b>47.705.800</b>
4.1 Trajnime për shkathtësi të avancuara TI	300	Buxheti i APRMV - Nënlogaria e programeve dhe masave aktive të punësimit	36.000.000
4.2 Trajnime për shkathtësi të avancuara TI (me bashkëfinancim) për ofrues të palicencuar të trajnimeve	100	Buxheti i APRMV - Nënlogaria e programeve dhe masave aktive të punësimit	5.390.000
		Ofruesit e trajnimeve	5.610.000
<b>5. PUNA PRAKTIKE</b>	<b>1.413</b>		<b>39.271.000</b>
5. Puna praktike	1298	Buxheti i APRMV - Nënlogaria e programeve dhe masave aktive të punësimit	35.046.000
	75	Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) / Projekti Krijimi i mundësive të punës për të gjithë (UNDP)	2.187.000
	40	Buxheti i APRMV - IPA II - granti i katërt i drejtpërdrejtë	373.000
		Buxheti i APRMV - Nënlogaria e programeve dhe masave aktive të punësimit - Shlyerja e detyrimeve të mbetura nga PO 2020 në vitin 2021	1.665.000
<b>6. PROGRAMI I ANGAZHIMIT ME PUNË</b>	<b>1.050</b>		<b>9.275.200</b>
6. Punimet publike	1000	Buxheti i APRMV - Nënlogaria e programeve dhe masave aktive të punësimit	7.040.000
		Buxheti i komunave	1.848.000
	50	Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) / Projekti Krijimi i mundësive të punës për të gjithë (UNDP)	387.200
<b>7. EKONOMIA E KUJDESIT</b>	<b>970</b>		<b>159.254.536</b>
7.1 Puna e dobishme komunitare	500	APRMV - Nënlogaria e programeve dhe masave aktive kundrejt UNDP	45.092.250
		Buxheti i komunave	8.100.000
	200	Buxheti i komunave	16.200.000
	50	Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) / Projekti Krijimi i mundësive të punës për të gjithë (UNDP)	5.994.000

7.2 Trajnimi dhe punësimi i personave për dhënie të shërbimeve të kujdesit në komunitet për personat me aftësi të kufizuar dhe personat me sëmundje kronike në komunitet	150	APRMV - Nënlogaria e programeve dhe masave aktive kundrejt UNDP	46.316.171
		Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) / Projekti Krijimi i mundësive të punës për të gjithë (UNDP)	11.625.120
7.3 Mbështetja e sipërmarrësisë dhe formimi i subjekteve juridike, dhënësve të shërbimeve të kujdesit në komunitet	70	APRMV - Nënlogaria e programeve dhe masave aktive kundrejt UNDP	20.704.115
		Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) / Projekti Krijimi i mundësive të punës për të gjithë (UNDP)	5.222.880
<b>1.Pagimi i shtesës rinore</b>	<b>2500</b>	<b>APRMV - Nënlogaria e programeve dhe masave aktive të punësimit</b>	<b>100.931.514</b>
<b>GJITHSEJ PERSONA:</b>	<b>10.279</b>	<b>GJITHSEJ FONDE:</b>	<b>1.516.010.152</b>

**TABELA 2. Shtrirja e personave me shërbime punësimi**

<b>II. SHËRBIMET E PUNËSIMIT <sup>1</sup></b>	<b>SHTRIRJA E PERSONAVE</b>	<b>BURIMI I FONDEVE</b>	<b>SHUMA</b>
5. Aktivizimi i romëve të papunë dhe personave të tjerë të rrezikuar nga përjashtimi social	1.500	Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) / Projekti Krijimi i mundësive të punës për të gjithë (UNDP)	7.042.002
8. Sondazhi mbi nevojat e shkathtësive në tregun e punës	20	<b>APRMV</b> - Nënlogaria e programeve dhe masave aktive të punësimit	180.000
Rehabilitimi profesional dhe përfshirja në tregun e punës e personave me aftësi të kufizuar	90	Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) / Projekti Krijimi i mundësive të punës për të gjithë (UNDP)	7.791.732
		<b>GJITHSEJ FONDE:</b>	<b>15.013.734</b>

1.Shërbimet e tjera të punësimit po realizohen në kuadrin e aktiviteteve aktuale të APRMV

	<b>TABELA 3. BURIMET E FINANCIMIT</b>	<b>SHUMA</b>
1	Buxheti i APRMV - Nënllogaria e programeve dhe masave aktive të punësimit	308.444.800
2	Buxheti i APRMV - Nënllogaria e programeve dhe masave aktive të punësimit me pagimin e SHITESËS RINORE	100.931.514
3	Buxheti i MPPS kundrejt APRMV	538.000.000
4	Buxheti i APRMV - Nënllogaria e programeve dhe masave aktive të punësimit, kundrejt UNDP	115.405.186
5	Buxheti i APRMV - Nënllogaria e programeve dhe masave aktive të punësimit - Shlyerja e detyrimeve të mbetura nga PO 2020 në vitin 2021	7.718.500
6	Buxheti total i APRMV - Nënllogaria e Fondit të Posaçëm për Personat me Invaliditet	289.500.000
7	Buxheti i AMSRMV <sup>1</sup>	15.000.000
8	Buxheti i APRMV - IPA II - granti i katërt i drejtpërdrejtë - masat e punësimit	24.385.480
9	Buxheti i komunave	26.148.000
10	Buxheti i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (Projekti Krijimi i mundësive të punës për të gjithë - UNDP)	49.192.334
11	UNDP (fondet e perealizuara nga PO 2020)	17.592.897
12	Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (Projekti Arsimimi për Punësim në Maqedoninë e Veriut E4E@mk)	3.024.000
13	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Mbështetjen e Projekteve (UNOPS) - shlyerja e detyrimeve të mbetura nga PO 2020 në vitin 2021	24.540.000
14	Shoqata REDI Shkup	5.531.175
15	Ofruesit e trajnimeve	5.610.000
	<b>Gjithsej:</b>	<b>1.531.023.886</b>

1. Shpërblimi i këshilltarëve për hartimin e planit të biznesit me çmim nga 9.900,00 denarë, përfshirë dhe TVSH, Shpërblimi administrativ për kontraktuesit rajonal në shumë prej 1.300,00 denarësh për klient

